

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5614  
E hënë, 29 tetor 2018  
çmimi 0.40 €

## Rritet buxheti për komunitat



Projektbuxheti i vitit 2019 parasheh rritje të buxhetit për komunitat në vlerë prej 40 milionë eurosh

Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE" DREJTORI I RI I KEK-UT,  
NJAZI THAÇI

## KEK-u do të jetë korporata më fitimprurëse në vend

Drejtori menaxhues i Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), Njazi Thaçi, ka thënë se do të angazhohet që KEK-u të jetë korporata më fitimprurëse në vend si në aspektin gjenerues, po ashtu edhe në atë të mirëqenies sociale. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se do të angazhohet që të rriten të hyrat e korporatës duke e zhvilluar edhe sektorin e shitjes së thëngjillit. Sipas Thaçit, kjo pasuri duhet të shfrytëzohet në të mirë të

rritjes ekonomike dhe sociale. Ai ka thënë se objektivi tjetër i tij është që tokat e degraduara, në të cilat është nxjerr thëngjilli, të kthehen në shfrytëzim për të gjeneruar të hyra. Ndërkaq duke folur për furnizimin me energji elektrike gjatë sezonit të dimrit, Thaçi ka thënë se janë bërë përgatitjet që KEK-u të jetë në prodhim me maksimumin e kapaciteteve prodhuese, po ashtu ka treguar se kanë arritur të krijojnë rezerva të mjaftueshme të thëngjillit për sezonin e dimrit



### AKTUALE

**PSE MENDOJ SE FATMIR XHAFAJ GABOI KËTË HERË** F. 12



Nga Bedri ISLAMI

**NAIM TËRNAVA RIZGJEDHET NË KRYE TË BIK-ut** F. 3

**MILAIM ZEKA: KUVENDI PAGUAN 6 000 EURO NË MUAJ VETËM QIRA PËR VETURA** F. 7

**PACOLLI: AKR-JA ËSHTË PARTI QË I SHTYN PËRPARA PROCESET** F. 6

### EKONOMI

**INTERESIM I MADH I BIZNESEVE TË HUAJA PËR INVESTIME NË KOSOVË** F. 9

**PENSIONET RRIEN NGA 15 DERI 34 EURO NË MUAJ** F. 9



### SPORT

**KOSOVA RRËMBEN KATËR MEDALJE NË ABU DHABI** F. 14

**'EL CLASICO' E BARCELONËS** F. 14

PËRFAQËSUESIT E PARTIVE POLITIKE KANË SHTUAR AKTIVITETET E TYRE NËPËR STRUKTURAT PARTIAKE

## Analistët thonë se nuk është koha e përshtatshme për zgjedhje të reja

Ndonëse liderët e subjekteve politike të koalicionit qeverisës kanë shtuar aktivitetin e tyre në terren, duke takuar strukturat partiake, ata kanë mohuar se ky është sinjal për zgjedhje të reja. Edhe analistët politikë nuk besojnë se zgjedhjet e reja do të mund të mbahen së shpejti pasi, sipas tyre, zgjedhjet tani për tani nuk janë në rend të ditës



**Vetëvendosje: Për papërgjegjësitë e veta për vizat, Qeveria fajëson BE-në**

F. 6

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Kurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANK VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Cooperi: Nuk mund të ketë ndryshim kufijsh

PRISHTINË, 28 TETOR - Në kohën kur temë kryesore është "korrigjimi i kufirit" Kosovë-Serbi, ish-ndërmjetësi i dialogut teknik në mes Kosovës dhe Serbisë, Robert Cooper, thotë që vëmendje e madhe duhet t'i kushtohet edhe implementimit të marrëveshjeve të arritura deri më tash në mes të dy vendeve. Ndërsa për të parën thotë se duhet pasur kujdes të posaçëm, duke rekomanduar konsulta me

vendet fqinje për shkak të evitimit të lëkundjeve të mundshme të stabilitetit sigurisë në rajon.

Cooper, në një intervistë për "KosovaPress", flet po ashtu edhe për marrëveshjen përfundimtare me Serbinë, ku thotë se nuk dëshiron të spekulojë se kur mund të ndodhë një gjë e tillë.

Sa i përket idesë së presidentit Hashim Thaçi për "korrigjim të

kufirit", diplomati britanik thotë se kufijtë nuk mund të ndryshohen vazhdimisht, ndërsa shton se nëse ekziston një marrëveshje e tillë, duhet konsultuar të gjitha vendet e rajonit, pasi që Ballkani, sipas tij, është një vend i vogël. E para se vendet perëndimore të vendosin nëse do të mbështesin këtë ide, ai thotë, se së pari duhet të bëhen publike të gjitha detajet e përmbajtjes të saj.



## Dorëhiqet Xhafaj, Lleshi emërohet ministër i Brendshëm

Ministri i ri i Punëve të Brendshme të Shqipërisë, Sandër Lleshi, ka një karrierë të gjatë si ushtarak dhe prej 2013-s ka qenë i përzgjedhuri i kryeministrit si këshilltar për çështjet e mbrojtjes



TIRANË, 28 TETOR - Me një lëvizje surprizë, kryeministri Edi Rama ka njoftuar nëpërmjet "Twitter"-it dorëheqjen e ministrit të Brendshëm Fatmir Xhafaj dhe emërimin e zëvendësuesit të tij, gjeneral Sandër Lleshi. Tepër befasuese është "braktisja" e misionit nga Xhafaj, por më shumë është emri i zgjedhur nga Rama për ta drejtuar dikasterin më të rëndësishëm të qeverisë, që është goditur në dy mandate nga skandalet e narkotrafikut dhe lidhjet e ministrave me bandat e drogës.

Lleshi ka një karrierë të gjatë si ushtarak dhe prej 2013-s ka qenë i përzgjedhuri i kryeministrit si këshilltar për çështjet e mbrojtjes. Asokohe kur e prezantonte, Rama tha se emrin e Lleshit e kishte dëgjuar nga shkrimtari i madh Ismail Kadare. "Emrin e Sandër Lleshit e kam dëgjuar për herë të parë nga Ismail Kadare, i cili ua sugjeroi palëve si një kandidat të Republikës një vit më parë. Më vonë munda ta çmoj përmes medieve kur denoncoi publikisht rrënimin e

Ministrit të Mbrojtjes dhe degradimin e rëndë të drejtimit të ushtrisë sonë. Dhe njohja nga afër erdhi kur pas zgjedhjeve e thirra për ta dëgjuar lidhur me gjithë çka kishte denoncuar publikisht, si edhe me idetë e tij për të ardhmen e dikasterit qendror të mbrojtjes si edhe të vetë Forcave të Armatosura natyrisht. Pas disa komunikimesh kuptova besoj, arsyet pse shkrimtari i shquar e kishte menduar si president të denjë për vendin këtë gjeneral të panjohur. I edukuar në perëndim, njohës i mirë i historisë dhe bartës i modestisë intelektuale që karakterizon të diturit, zotëruar i thellë i fushës jo vetëm nga librat po edhe nga rrugëtimi i një karriere të gjatë", thoshte Rama për ministrin e ri të Brendshëm.

Në periudhën 1996-2000, gjeneral Lleshi ka qenë komandant i Kurseve në Akademinë e Mbrojtjes në Tiranë dhe më pas, për tre vjet të tjera, ishte komandant i Akademisë Ushtarake "Skënderbej".

Në vitet 2003-2006 ka shërbyer si atashë i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë në

Gjermani. Sa i takon arsimit të tij në fushën ushtarake, ai fillon në periudhën 1978-1985 kur ka kryer shkollën e Mesme Ushtarake "Skënderbej" dhe Akademinë Ushtarake.

Nga viti 1994 deri në 1999 ka kryer një sërë kursesh, si ai i gjuhës gjermane në Akademinë e Mbrojtjes Kombëtare në Vjenë (Austri); kurs i avancuar i gjuhës gjermane në Institutin Federal të Gjuhëve (Bundessprachenamt) në Gjermani; kurs i komandantit të Batalionit në Shkollën e Artilerisë Kundërajrore në

Rendsburg, Gjermani; kurs i Shtabit të Përgjithshëm në Akademinë e Drejtimit në Hamburg, Gjermani dhe kurs i Sigurisë Evropiane në Akademinë e Drejtimit në Hamburg, Gjermani.

Në 2008-n, gjeneral Lleshi ka përfunduar seminarin e lartë ekzekutiv në Qendrën për Studime të Sigurisë Evropiane, George C. Marshall në Garmisch-Partenkirchen, Gjermani; ndërsa në 2011-ën përfundoi Kursin e Lartë Ndërkombëtar për Menaxhimin e Mbrojtjes në Shkollën

Pasuniversitare të Marinës në Monterey, Kalifornia, SHBA.

Kryeministri Edi Rama të shtunën ka konfirmuar dorëheqjen e ministrit të Brendshëm Fatmir Xhafaj. "Pranova dorëheqjen e ministrit Xhafaj, të cilin e falënderoj për kontributin e çmuar. Gjeneral Sandër Lleshi do të sjellë një energji të re pozitive në krye të Punëve të Brendshme. Traseja është e shtruar. Tani duhet rritur shpejtësia dhe duhen arritur rezultate edhe më domethënëse", kishte shkruar Rama në "Twitter".

## Spanja përkrah integrimin e Maqedonisë në NATO dhe BE

SHKUP, 28 TETOR - Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim, Ali Ahmeti, ka pritur ambasadorin e Spanjës në Maqedoni, Emilio Lorenzo Serra, ku kanë biseduar për zbatimin e Marrëveshjes së Prespës, ndryshimet kushtetuese, si dhe për situatën në rajon.

Kryetari Ahmeti theksoi pritjet e tij që mbështetja në kuvend për procesin integruar të vendit të rritet edhe më tej gjerë në përfundim të suksesshëm të procesit.

Sipas një komunikate të BDI-së, ky subjekt politik do ta vijojë dialogun me deputetët dhe partitë parlamentare në mënyrë që

të zgjerohet mbështetja në muajt në vijim.

Ambasadori Serra vuri theksin mbi përkrahjen e Spanjës për integrimin e Maqedonisë në NATO dhe në Bashkimin Evropian. Në takim u diskutua edhe rreth situatës në rajon dhe rrethanat aktuale gjeopolitike dhe gjeostrategjike.



Përfaqësuesit e partive politike kanë shtuar aktivitetet nëpër strukturat partiake

# Analistët thonë se nuk është koha e përshtatshme për zgjedhje të reja

Ndonëse liderët e subjekteve politike të koalicionit qeverisës kanë shtuar aktivitetin e tyre në terren, duke takuar strukturat partiake, ata kanë mohuar se ky është sinjal për zgjedhje të reja. Edhe analistët politikë nuk besojnë se zgjedhjet e reja do të mund të mbahen së shpejti pasi, sipas tyre, zgjedhjet tani për tani nuk janë në rend të ditës

**EPOKA  
ERE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 28 TETOR** - Liderët e subjekteve politike në pushtet dhe zyrtarët e lartë të tyre kanë shtuar në ditët e fundit aktivitetet në terren, duke i takuar strukturat partiake. Ndonëse zakonisht ky është marrë si sinjal për zgjedhje të reja, ata kanë mohuar një gjë të tillë. As njohësit e rrethanave politike këto aktivitete nuk i shohin si përgatitje për zgjedhje të reja.

Analisti politik Behxhet Shala ka deklaruar për "Epokën e re" se këto takime po bëhen për ta konsoliduar partinë dhe pozitën e liderit brenda subjektit politik. "Liderët politikë që po dalin në terren dhe po i takojnë strukturat partiake mund të interpretohet si mundësi për përgatitje për zgjedhje për testim të opinionit. Këto aktivitete mbahen edhe për konsolidim të partive politike apo për konsolidim të pozicioneve të liderëve partiakë brenda subjekteve politike që i udhëheqin", ka thënë Shala. Ai ka bërë me dije se tani për tani mbajtja e zgjedhjeve të reja është gati e pamundur. Sipas Shalës, formimi i ushtrisë, procesi i liberalizimit të vizave dhe disa procese të tjera duhet pritur para se të shkohet në zgjedhje. "Janë disa procese që thjesht nuk e lejojnë mbajtjen e zgjedhjeve. KQZ-ja nuk është e kompletuar ende, mirëpo ajo mund të kompletohet brenda një kohe të shkurtër. Pra, varet prej presidentit Thaçi nëse dëshiron ta komplettojë KQZ-në dhe nëse KQZ-ja kompletohet shpejt atëherë është një shenjë që mund të ketë zgjedhje. Mendoj se tani nuk është koha e përshtatshme për zgjedhje,

sepse jemi gati në muajin nëntor. Ndoshta mund të ketë zgjedhje deri në qershor të vitit të ardhshëm, nëse ndërkohë nuk lind ndonjë proces i cili i përshpejton zgjedhjet ose i shtyn për një kohë", është shprehur ai. Shala ka thënë se asnjë parti politike nuk i konvenojnë zgjedhjet e reja, duke shtuar se ato nuk do të sillnin asgjë të re. "Tani për tani asnjë parti nuk i konvenojnë zgjedhjet. Ndonëse të gjitha partitë po insistojnë se janë të gatshme për zgjedhje, nuk besoj se e kanë përnjëmend. LDK-ja po insiston në zgjedhje ngaqë beson se i fiton ato që, ndoshta, edhe i fiton, por diferenca do të jetë aq e vogël saqë do të jetë në pozitë të vështirë që të gjejë partnerë për ta formuar Qeverinë. Lëvizja Vetëvendosje ka ambicie të mëdha dhe e ka

problem. Ndërsa këto partitë e koalicionit qeverisës duan ta shtyjnë sa më shumë qëndrimin në pushtet", ka thënë ai.

Edhe liderët e koalicionit qeverisës kanë mohuar mundësinë se vendi mund të shkojë së shpejti në zgjedhje të reja. Sipas tyre, së pari duhet të përfundojnë disa procese me rëndësi kombëtare.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, njëherësh kryetar i PDK-së, Kadri Veseli, në kuadër të procesit të brendshëm zgjedhor të kësaj partie, në vazhdimësi po i viziton degët e PDK-së, duke kërkuar bashkimin e qytetarëve me këtë subjekt politik. "Ka nevojë Kosova për një adresë të sigurt politike, e cila i krijon siguri, e cila i krijon zhvillim, emancipim. Për t'i arritur sukseset në sfidat e reja politike, Kosova ka nevojë për një adresë të fuqishme politike. Një adresë e cila ka vizion, gatishmëri, dashuri për shtetin, për njerëzit e Kosovës. E kjo është platforma jonë e Dekadës së Re, për besim, zhvillim dhe integritet. Kjo është platforma e PDK-së", ka thënë Veseli teksa ka hapur procesin e

brendshëm zgjedhor në Mitrovicë e Vushtrri.

Kurse zëvendëskryeministri i Kosovës, njëherësh lider i Nismës, Fatmir Limaj, ka thënë se zgjedhjet e parakohshme nuk janë interes i Kosovës. "Kosova ka çështje të tjera më të rëndësishme me të cilat duhet të merret, para se të hyjë në zgjedhje të parakohshme. Vendi nuk duhet të mbesë peng i tyre, por të vazhdojë në zhvillime të tjera", ka thënë Limaj. Sipas tij, nuk ka asnjë sinjal se këtë vit do të ketë zgjedhje të reja, ndërsa takimet e fundit të partisë të cilën ai e drejton i ka quajtur të zakonshme, të punës brenda partisë. "Këtë vit askush nuk ka pritje reale. Besoj e dini se nuk ka asnjë shenjë që do të ketë zgjedhje këtë vit, por ne si parti punojmë dhe zhvillohemi, forcohemi, përgatitemi, kontaktojmë me elektoratin tonë, bashkëbisedojmë, raportojmë me elektoratin për të arriturat dhe kjo është një jetë politike normale që ne vazhdojmë rregullisht", ka deklaruar Limaj. As zëvendëskryeministri i parë dhe lideri i AKR-së, Behgjet Pacolli, nuk e ka përmendur

mundësinë e zgjedhjeve të reja. Derisa ka shpallur zyrtarisht procesin e brendshëm zgjedhor, Pacolli ka thënë se AKR-ja ka arritur synimet e veta si në pozitë dhe opozitë. Insistimin më të madh për zgjedhje po e tregon LDK-ja. Madje sekretari i përgjithshëm i LDK-së, Ismet Beqiri, së fundi është treguar më aktiv në këtë drejtim. Teksa po viziton degët e LDK-së, ai po shprehet i bindur se kjo parti do të dalë fituese në zgjedhjet e reja. "Në Vushtrrinë e traditës, Vushtrrinë që pas një pune të madhe të palodhshme të strukturave, anëtarëve, simpatizantëve tanë, udhëhequr nga kryetari i Degës, Hysni Gërguri, u kthye qeverisja e LDK-së në krye me kryetarin e Komunës, z. Xhafer Tahiri. Me besim e angazhim të shtuar, për fitoren e re të LDK-së në zgjedhjet e ardhshme nacionale", ka shkruar Beqiri në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe Lëvizja Vetëvendosje pretendon se institucionet aktuale kanë humbur legjitimitetin dhe se vendi duhet të shkojë në zgjedhje të reja.



## Naim Tërnavë rizgjedhet në krye të BIK-ut

**PRISHTINË, 28 TETOR (ER)** - Në mbledhjen e së shtunës, Trupi Zgjedhor i Bashkësisë Islame të Kosovës ka rizgjedhur Naim Tërnavën Myfti të Kosovës. Trupin Zgjedhor të Bashkësisë Islame të Kosovës e përbëjnë 60 anëtarë (30 anëtarët e Kuvendit të Bashkësisë Islame të Kosovës, 28 kryetarët e këshillave vendorë, dekan i FSI-së dhe drejtori

i Medresesë).

Kandidatë të propozuar për Myfti ishin Naim Tërnavë dhe Reshat Mexhidi. Tërnavë mori 52 vota, ndërsa kundërkandidati Reshat Mexhidi 6 vota, dy vota ishin të pavlefshme. Pas zgjedhjes, Myftiu Tërnavë para Trupit Zgjedhor paraqiti për miratim edhe anëtarët e Kryesisë: Ahmet Ramën për

rajonin e Prishtinës, Ejup Hazirin për rajonin e Mitrovicës, Musli Arifajn për rajonin e Pejës, Valon Myrtën për rajonin e Gjakovës, Reshat Mexhidin për rajonin e Prizrenit, Fehmi Mehmetin për rajonin e Ferizajt, Ilmi Krasniqin për rajonin e Gjilanit dhe Sulejman Fejzullahun për rajonin e Preshevës.

Flet për "Epokën e re" drejtori i ri i KEK-ut, Njazi Thaçi

# KEK-u do të jetë korporata

## - Jam i bindur se do t'i vazhdojmë trendët e rritjes për ta mbajtur kompaninë me fitimprurëse në vend

Drejtori menaxhues i Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), Njazi Thaçi, ka thënë se do të angazhohet që KEK-u të jetë korporata më fitimprurëse në vend si në aspektin gjenerues, po ashtu edhe në atë të mirëqenies sociale. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se do të angazhohet që të rriten të hyrat e korporatës duke e zhvilluar edhe sektorin e shitjes së thëngjillit. Sipas Thaçit, kjo pasuri duhet të shfrytëzohet në të mirë të rritjes ekonomike dhe sociale. Ai ka thënë se objektivi tjetër i tij është që tokat e degraduara, në të cilat është nxjerr thëngjilli, të kthehen në shfrytëzim për të gjeneruar të hyra. Ndërkaq duke folur për furnizimin me energji elektrike gjatë sezonit të dimrit, Thaçi ka thënë se janë bërë përgatitjet që KEK-u të jetë në prodhim me maksimumin e kapaciteteve prodhuese, po ashtu ka treguar se kanë arritur të krijojnë rezerva të mjaftueshme të thëngjillit për sezonin e dimrit


**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 28 TETOR** - Pas një gare maratonike javën e kaluar është zgjedhur drejtori menaxhues i Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK). Pozitën më të lartë në këtë ndërmarrje e ka marrë Njazi Thaçi, magjistër i diplomuar i shkencave elektroteknologjike në Universitetin e Tiranës, duke u vlerësuar me pikët maksimale nga anëtarët e Bordit të Drejtorëve të KEK-ut, si dhe ekspertët e Ambasadës së Britanisë. Gazeta "Epoka e re" sjell intervistën e parë për media të Njazi Thaçit pas zgjedhjes së tij në krye të KEK-ut. Në këtë intervistë Thaçi ka shpalosur objektivat për menaxhimin e ndërmarrjes më të fuqishme financiare në vend, për ambiciet e zhvillimit të KEK-ut, për dilemat e ngritura nga sindikatat se a po rrezikohet korporata si pasojë e mungesës së punëtorëve të rinj, si dhe për mundësinë e pasjes së krizës energjetike gjatë sezonit dimëror. Ai në këtë intervistë ka folur edhe për projektet e mëdha kapitale që synon t'i realizojë, në mënyrë që, sipas tij, ta shndërroj korporatën në një aset edhe më të fuqishëm dhe jo vetëm në prodhim të energjisë

elektrike, por edhe në zgjerim të kapaciteteve gjeneruese në thëngjill. Përveç të tjerash, Thaçi ka shpalosur edhe një ide që s'është përmendur asnjëherë më parë, e që është shndërrimi i tokave të KEK-ut në prodhim të energjisë solare. Ai ka treguar edhe për bashkëpunimin me Korporatën Shqiptare, për rëndësinë e interkoneksionit dhe për përgatitjet që ka bërë KEK-u për të furnizuar me energji elektrike gjatë sezonit të dimrit.

**"Epoka e re":** Z. Thaçi, sapo jeni emëruar drejtor në KEK, cilat janë objektivat e juaja për këtë mandat?

**Thaçi:** Fillimisht më lejoni të përsëris atë që tashmë është realitet. KEK-u është historia më e suksesshme e zhvillimit në Kosovë jo vetëm nëse e krahasojmë me ndërmarrjet publike, por edhe me kompani të tjera. Pra, flasim për një dekadë të sukseseve të shndërrimit të një kompanie thuhet të shkatërruar në një gjigant ekonomik. Falë një menaxhimi shumë të mirë dhe pune shumë të madhe kemi arritur që Korporatën, si pasuri publike, ta kthejmë në dobi të shtetit dhe në interes të qytetarëve. Përveç pasurimit të buxhetit të shtetit, jemi faktori më i madh



social në vend me mbi 4 800 të punësuar. Objektivat e mia janë të qarta dhe do të angazhohem që t'i realizoj në përpikëri. Siç e dini, unë e njoh mirë se si funksionin korporata, pasi jam pjesë e menaxhmentit gjatë gjithë kësaj periudhe të rritjes. Jam i bindur se do t'i vazhdojmë trendët e rritjes për ta mbajtur kompaninë me fitimprurëse në vend. Do t'i rrisim të hyrat e korporatës duke e zhvilluar edhe sektorin e shitjes së thëngjillit. Kosova është vendi i tretë në Evropë me rezervat me të mëdha të thëngjillit, prandaj

është më se e nevojshme dhe e domosdoshme që kjo pasuri të shfrytëzohet në të mirë të rritjes ekonomike dhe sociale. Objektivi tjetër imi është që tokat, siç i quajmë ne të degraduara, pra aty ku është nxjerr thëngjilli apo ku kemi pasur deponitë e hirit dhe që janë mbuluar, t'i kthejmë në shfrytëzim për të gjeneruar të hyra. Do të bëjmë studimin e fizibilitetit dhe do ta hartojmë planin që këto toka t'i shndërojmë në parqe solare. Bazuar në kushtet natyrore dhe teknike, është më se e nevojshme

që të shfrytëzohen në këtë mënyrë.

**"Epoka e re":** Është paralajmëruar krizë energjetike në Kosovë. Çfarë situatë mund të kemi gjatë sezonit dimëror?

**Thaçi:** Kjo s'varet vetëm nga KEK-u. Siç e dini, tash e sa vjet janë ndarë përgjegjësitë dhe secili operator në treg ka obligimet e veta në këtë proces. KEK-u ka obligim të prodhojë energji elektrike dhe t'i përmbahet planit konform licencës, ndërsa garantimin për furnizim të qytetarëve me energji

# më fitimprurëse në vend



elektrike e kanë operatorët e tjerë në treg që janë të licencuar për këtë punë. Ne mund të garantojmë se i kemi bërë të gjitha përgatitjet që të jemi në prodhim me maksimumin e kapaciteteve tona prodhuese, po ashtu kemi arritur të krijojmë rezerva të mjaftueshme të thëngjillit për sezonin e dimrit. Po kryhen të gjitha remontet e planifikuara, njëkohësisht kemi arritur që në të njëjtën kohë ta furnizojmë rrjetin me sasi të nevojshme të energjisë gjatë kësaj periudhe. Pra, aktualisht kemi në remont

vetëm Bllokun "B1" të Termocentralit "Kosova B" dhe të tjerët janë në prodhim. Nga 15 dhjetori do të jemi në prodhim me 4 bllqe, dy në Termocentralin "Kosova A" dhe dy në "Kosova B". Pra, ajo që varet nga puna dhe menaxhimi i KEK-ut është e garantuar se do ta furnizojmë tregun me energji elektrike maksimalisht sa na ofrojnë kapacitetet tona.

**"Epoka e re":** Bllokimi i interkonjksionit me Shqipërinë sa është duke e dëmtuar KEK-un dhe cili është

apeli juaj?

**Thaçi:** Kjo temë është debatuar shumë dhe ne e kemi potencuar në vazhdimësi që është në interes të madh të korporatës funksionalizimi i linjës 400 KV. Kjo do t'i mundësonte KEK-ut shkëmbim më të madh të energjisë edhe me Shqipërinë, por edhe me vendet e tjera të BE-së. Por, në këtë aspekt asgjë nuk varet nga KEK-u, por është problem i KOSST-it. Pra, funksionalizimi i saj është jashtë kompetencave tona. Ne s'mund të bëjmë asgjë në këtë drejtim, por mund të themi se

kjo linjë është interes jo vetëm i KEK-ut, por interes kombëtar.

**"Epoka e re":** Cili është bashkëpunimi aktual me Shqipërinë?

**Thaçi:** KEK-u dhe Korporata Energjetike Shqiptare (KESH) kanë ndërtuar një bashkëpunim të shkëlqyeshëm, tamam vëllazëror. Personalisht kam qenë person përgjegjës që kemi hartuar marrëveshjet e bashkëpunimit duke i njohur edhe nga afër drejtuesit e KESH-it me shumicën e të cilëve kemi studiuar bashkë në Universitetin e Tiranës. I jemi gjetur njëri-tjetrit duke mos kalkuluar shumë çmimet e tregut, por duke punuar në interes të qytetarëve tanë. Kemi mbuluar nevojat e dy shteteve me shkëmbim të energjisë elektrike 1 me 1. Pra, jemi furnizuar me energji nga KESH-i, kur kemi pasur mungesa dhe e kemi kthyer sasinë e njëjtë dhe anasjelltas. Veç kësaj, në vazhdimësi kemi bërë harmonizimin e bilanceve energjetike në mënyrë që të shkëmbejmë sa më shumë energji dhe në dy shtetet tona t'i ulin importet e shtrenjta të energjisë elektrike. Duke parë këtë bashkëpunim të mirë dhe miqësinë e mirë dhe vullnetin nga të dyja anët, në të ardhmen do të punoj që ta thellojmë edhe më shumë bashkëpunimin dhe t'i shohim edhe mënyrat e bashkëfinancimit për resurset e reja të energjisë.

**"Epoka e re":** Çfarë kapacitetesh të rezervave keni dhe sa i përket qymyrit, a do të kemi sfida si në vitin e kaluar?

**Thaçi:** E theksuam edhe më herët, KEK-u vitin e kaluar ka qenë në një krizë të madhe të thëngjillit jo për shkak tonin, por për shkak të problemeve që u shfaqën me vonesat në shpronësime. Fatmirësisht, u tejkalua ky problem edhe me angazhimin e Qeverisë dhe aktorëve të tjerë. Me sukses kemi arritur ta përfundojmë procesin e shpronësimeve sa iu përket obligimeve tona dhe menjëherë është filluar puna dhe brenda një periudhe të shkurtër kemi arritur t'i krijojmë rezervat e mjaftueshme. Në këtë aspekt s'pritet të kemi sfida apo probleme gjatë sezonit të dimrit.

**"Epoka e re":** Po ashtu, sa iu përket filtrave dhe impianteve të vjetruara, a pritet të ketë ndonjë investim?

**Thaçi:** Ju e dini se deri tani janë bërë shumë investime në këtë aspekt. Kemi bërë maksimumin bazuar në kapacitetet

tona. Gjendja e termocentraleve të vjetra na ka sjellë këto sfida, pra janë dashur investime të mëdha për të arritur në normat e lejuara. Por, në vazhdimësi kemi bërë investime dhe falë mbështetjes së BE-së, USADI-it dhe organizatave të tjera, kemi zvogëluar në maksimum ndotjen. Edhe tani jemi duke punuar që të krijojmë një ambient sa më të pastër dhe ta reduktojmë në maksimum ndotjen. BE-ja ka dhënë një donacion prej 79 milionë eurosh për ndërtimin e filtrave të ri në Termocentralin "Kosova B" dhe komponentët e tjerë ambientalë, ata të DNOX. Në këtë drejtim do të vazhdojmë të bashkëpunojmë me organizatat e BE-së, me USAID-in, Ambasadën Amerikane dhe të tjerët të cilët në vazhdimësi na kanë përkrahur dhe i jemi falënderues.

**"Epoka e re":** A ka nevojë KEK-u për 800 punëtorë siç po kërkojnë sindikatat e punëtorëve?

**Thaçi:** Në vazhdimësi ka pasur nevojë për plotësimin e vendeve të punës dhe për regrutimin e kuadrove të reja profesionale. Ne i kemi disa analiza që janë bërë sa i përket numrit të punëtorëve të cilët janë para pensionimit dhe numrit të madh të punëtorëve që kanë dalë në pension vitet e fundit. Mund të themi se është një sfidë për shkak të moshës së punëtorëve, por nuk bën asnjëherë të veprojmë pa i bërë mirë planifikimet buxhetore. Strategjia e KEK-ut është që të krijojë kuadro të reja, t'i mbështetë punëtorët e saj dhe të punësojë staf aq sa është i domosdoshëm, por asnjëherë nuk do të veprohet në atë mënyrë që të kemi mbipunësime dhe të rrezikohet shtylla financiare e Korporatës. Në fund, dua edhe një herë t'i falënderoj të gjithë aktorët që janë pjesë e proceseve dhe zhvillimit të objektivave të KEK-ut. Një falënderim për Bordin e Drejtorëve të KEK-ut dhe përfaqësuesve të Ambasadës Britanike për besimin që ma kanë dhënë për ta menaxhuar korporatën. Qeverinë e Kosovës, MZHE-në, zyrën e BE-së në Kosovë, Ambasadën Amerikane, USAID-in, shoqërinë civile dhe mediat, po ashtu edhe të gjithë punëtorët e Korporatës për mbështetjen e vazhdueshme, pa të cilët Korporata nuk do të ishte kjo që e kemi sot.

Aleanca Kosova e Re (AKR) ka filluar procesin e brendshëm të zgjedhjeve

## Pacolli: AKR-ja është parti që i shtyn përpara proceset

Presidenti i Aleancës Kosova e Re (AKR), Behgjet Pacolli, me rastin e shpalljeve të zgjedhjeve në parti, ka thënë se AKR-ja është parti që i shtyn përpara proceset. Ndërkaq zëvendëskryetari i AKR-së, Agim Bahtiri, ka thënë se etapa e re e AKR-së po fillon edhe më e fuqishëm



vlora e resurse të cilat nuk i gjen në partitë e tjera. Kjo parti na nderon, andaj u bëj thirrje të gjithëve që të dëshmojmë edhe një herë që puna e kontributi ynë janë të duhurat për Kosovën", ka thënë Bahtiri. Me këtë proces Aleanca Kosova e Re

do t'i zgjedhë organet e reja drejtuese të partisë duke punuar edhe për shtrirjen dhe zgjerimin e saj të mëtutjeshëm, me ardhjen e një numri të madh të anëtarëve të rinj. Për organizimin e zgjedhjeve të brendshme në AKR, më tej do të

përcaktohet puna, funksionimi, komisionet përkatëse si dhe çështjet e tjera me rëndësi për procesin e zgjedhjeve të brendshme dhe organizimin e kuvendit qendror të partisë si dhe kuvendet e degëve dhe të nëndegëve.

### **EPOKA E RE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 28 TETOR - Përmes një ceremonie solemne, Aleanca Kosova e Re (AKR) zyrtarisht të shtunën ka shpallur zgjedhjet e brendshme në të gjitha nivelet. Në këtë tubim të Aleancës Kosova e Re ku, përveç presidentit të partisë, Behgjet Pacolli, të pranishëm ishin edhe anëtarët e Këshillit Drejtues, kryesisë, përfaqësuesit e Aleancës Kosova e Re nëpër institucione si dhe kryesitë e forumeve. Presidenti i AKR-së, Behgjet Pacolli, ka thënë se partia të cilën e udhëheq është në shërbim të qytetarëve dhe të gjeneratave të reja. "E kemi obligim që të punojmë me nder dhe sinqeritet. Tash e 12 vjet ne ju kemi përmbajtur pikave

tona. AKR-ja është parti që punon për interesat e qytetarëve të saj, punon për zhvillim ekonomik dhe për shtyrjen përpara të proceseve. Jam betuar që do të punoj vetëm për interesat e Kosovës", ka thënë Pacolli, duke i falënderuar të gjithë të rinjtë dhe ekspertët e fushave të ndryshme të cilët kishin shprehur interesimin e tyre për t'iu bashkuar programit zhvillimor të AKR-së. Pacolli ka thënë se këto zgjedhje të brendshme janë një mundësi e mirë për t'i dhënë fund asaj që është e papranueshme për popullin dhe për t'i hapur derën kontributit të frymës zhvillimore. Ndërkaq zëvendëskryetari i AKR-së, Agim Bahtiri, ka thënë se etapa e re e AKR-së po fillon edhe më e fuqishme. "Aleanca Kosova e Re është parti që ka

## Vetëvendosje: Për papërgjegjësitë e veta për vizat, Qeveria fajëson BE-në

### **EPOKA E RE** Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 TETOR - Lëvizja Vetëvendosje, nëpërmjet deputeteve Fitore Pacolli dhe Albulena Haxhiu, ka mbajtur një konferencë për medie në lidhje me deklaratat e fundit të Qeverisë për liberalizimin e vizave. Deputetja Pacolli ka thënë se qeveritarët në vazhdimësi kanë manipuluar me çështjen e vizave "Shumë herë është festuar përfundimi i këtij procesi dhe shumë pak është punuar për përmbylljen e tij. Ky proces në fillim u përdor si premtime elektorale, më vonë u përdor si karrem për kalimin e marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi, më pas edhe si alibi për ta sulmuar Lëvizjen Vetëvendosje për bllokimin e tij. Nga deklaratat e fundit të zëvendëskryeministrit Enver Hoxhaj, se BE-ja po tregohet albanofobe dhe se ne na duhet ta rishikojmë qasjen ndaj saj, u kuptua se Qeveria ka informacione të cilat nuk po i ndan me qytetarët se disa prej shteteve kryesore të Bashkimit Evropian nuk do ta mbështesin në dhjetor

liberalizimin e vizave në mbledhjen e Këshillit të Ministrave", ka thënë Pacolli. Ajo ka bërë me dije se shumë shtete të BE-së janë kundër vizave por, sipas saj, Qeveria është duke e mbajtur të fshehtë këtë qëndrim të tyre. "Ne kemi disa të dhëna se nga takimet e fundit teknike, pas vendimit të Komisionit Evropian dhe të Parlamentit, del se një numër i madh i shteteve janë kundër liberalizimit të vizave. Qeveria ka më shumë informacione, mirëpo këto nuk po i ndan me ne dhe me qytetarët e vendit, por po kërkon gjetjen e fajtorit. Nuk po e konsideron veten, por qytetarët e Kosovës dhe BE-në fajtorë", ka thënë ajo. Ndërsa deputetja tjetër e Vetëvendosjes, Albulena Haxhiu, ka thënë se nga sistemi i korruptuar i drejtësisë, te nisma e fundit e presidentit Hashim Thaçi për shkëmbim territoresh dhe deri te skandalet e njëpasnjëshme të pushtetit, Qeveria është e gatshme ta ndryshojë qasjen ndaj aleatëve tanë evropianë dhe ta shoh mundësinë për bashkëpunim me vende si Rusia vetëm për të



mos marrë përgjegjësi për veprimet e saj. "Si të veprojë Bashkimi Evropian kur një prokuror si Blakaj detyrohet të ikë nga Kosova për shkak të kërcënimeve që merr?! Si të veprojë Bashkimi Evropian kur përcjell ngjarje si ajo kur policia dhe prokuroria dalin me deklaratat të ndryshme në kohën kur djali i

kryespiunit Shpend Maxhunit arrestohet me armë?! Si të veprojë Bashkimi Evropian kur kryeprokurori i shtetit Lumnezi del në mbrojtje të Shpend Maxhunit?! Si të veprojë Bashkimi Evropian kur sheh se për pazare vëllai i presidentit sulmon fizikisht dy persona, ndërsa kushëriri i tij, i cili është i

akuzuar për keqpërdorime, vendoset në krye të KEK-ut", ka thënë Haxhiu. Pacolli dhe Haxhiu kanë theksuar se qytetarët e Kosovës e meritojnë liberalizimin e vizave por, sipas tyre, kjo mund të realizohet vetëm me largimin nga pushteti të kësaj klike politike të papërgjegjshme dhe kriminale.

# Rritet buxheti për komunat

Projektbuxheti i vitit 2019 parasheh rritje të buxhetit për komunat në vlerë prej 40 milionë eurosh. Përderisa në vitin 2018 buxheti për nivelin lokal ka qenë 491 milionë euro, për vitin 2019 ky buxhet do të jetë në vlerë prej 531 milionë eurosh. Buxheti mbi gjysmë miliardi euro parasheh qëndrueshmëri buxhetore për komunat, mundësi për mirëmbajtje të investimeve si dhe më tepër funksionalitet në shërbime

ketë rritje për kategorinë e shpenzimeve për mallra dhe shërbime si dhe do të ketë rritje për shpenzimet kapitale. "Ky buxhet i shprehur në shifra merr parasysh shpërndarjen e rritjes së shpenzimeve në këto kategori: a) kategoria e pagave dhe mëditjeve rritje për 6.7 milionë euro (zgjerimi i punësimit, mbulimi i punësimeve të nënbuxhetuara, si dhe rritja e pagave); b) rritja e shpenzimeve për mallra dhe shërbime në vlerë 13.6 milionë euro dhe c) rritja e shpenzimeve kapitale në vlerë 18.8 milionë euro apo në total investime 164.9 milionë euro", ka theksuar ai. Tahiri ka rikujtuar se në buxhetin për vitin 2019 janë buxhetuar edhe dy ligje, Ligji për Kryeqytetin dhe Ligji për Obiliqin. "Në këtë buxhet për herë të parë janë buxhetuar edhe dy ligje: ai për kryeqytetin, Prishtinën, në vlerë afro 11 milionë euro (10,841,400), dhe ai për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit, në vlerë afër 5 milionë (4,972,124). Deri në fund të

mandatit, bazuar strukturën e shpenzimeve për buxhetin komunal të vitit 2019 dhe parashikimeve për vitet 2020-2021, kryeqyteti përfiton grant shtesë afro 35 milionë euro (34,528,200), mjete këto që nuk prekin financimin e grantit të përgjithshëm për komunat në vlerë 10 % të buxhetit total të Republikës së Kosovës", ka thënë Tahiri. Koordinatori Nacional për Reforma Shtetërore ka thënë se projektbuxheti i vitit 2019 për nivelin komunal parasheh më shumë qëndrueshmëri buxhetore, mundësi në mirëmbajtje të investimeve si dhe më tepër funksionalitet në shërbime. "Pra, projektbuxheti i vitit 2019 për nivelin komunal, parasheh më shumë qëndrueshmëri buxhetore, më shumë mundësi në mirëmbajtje të investimeve dhe më tepër funksionalitet në shërbime, qofshin ato administrative apo sektoriale (arsim dhe shëndetësi). Pavarësisht prej rritjes, ende mbetet i pamjaftueshëm financimi nëpërmjet granteve

specifike (arsim dhe shëndetësi). Bazuar në projeksionet 2020-2021, ky përvitshëm projekt rritje deri në financim të qëndrueshëm në këto fusha. E njëkohësisht do t'i mbështesim komunat në rritjen e kapaciteteve dhe gamës për mbledhjen e të hyrave vetjake", ka shkruar Tahiri në llogarinë e vet në "Facebook". Sipas tij, në këtë kuadër mbështetja e shtuar nga qeveria qendrore, specifikisht ministritë e linjës, e fuqizon edhe më tej nivelin lokal në fushën e financimit, duke pasur parasysh se në këtë kuadër Kosova në vlerësime qëndron më së larti në rajon. "Këto ditë qeveria qendrore do të procedojë me aprovim të koncept-dokumentit për financat e pushtetit lokal, duke avancuar edhe më tej politikë që promovojnë financimin dhe menaxhimin efikas të komunave. Kjo dhe mbështetja përmes vendimeve dhe legjislacionit sektorial për nivelin lokal hap një perspektivë të re zhvillimore", është shprehur Tahiri.

**EPOKA ERE** Shqipe HETEMI

Prishtinë, 28 tetor - Koordinatori Nacional për Reforma Shtetërore, Besnik Tahiri, të dielën ka bërë me dije se buxheti i komunave për vitin 2019 do të jetë në vlerë prej 531 milionë eurosh apo 40 milionë më i lartë se buxheti i vitit 2018. Ai ka thënë se Projektbuxheti për vitin 2019 dhe projeksionet për periudhën 2020-2021 janë tregues i qartë se në Kosovë ka një mendësi ndryshe qeverisëse. "Buxheti komunal i vitit 2019 arrin vlerën 531 milionë euro, apo 40 milionë më i lartë krahasuar me atë të vitit

2018 që ishte 491 milionë euro. Shprehur në përqindje, i bie 8 %. Buxheti tashmë mbi gjysmë miliardi euro për komunat merr parasysh projeksionet në rritje në të gjitha kategoritë buxhetore, duke përfshirë rritje të ndjeshme në grantet specifike (arsim dhe shëndetësi). Komunat, krahasuar me vitin 2018, në 2019-n kanë financim shtesë në arsim 14.7 milionë euro, ndërsa në total 185 milionë euro, ndërkaq në shëndetësi 4.9 milionë euro. Shprehur në total, 53.4 milionë euro", ka deklaruar Tahiri, duke shtuar se me anë të këtij buxheti do të ketë rritje për kategorinë e pagave dhe të mëditjeve, do të



## Milaim Zeka: Kuvendi paguan 6 000 euro në muaj vetëm qira për vetura

PRISHTINË, 28 TETOR (ER) - Deputeti i Nismës Socialdemokrate, Milaim Zeka, ka bërë me dije se Kuvendi i Kosovës paguan 6 000 euro vetëm qira për vetura. Sipas tij, makinat e dedikuara për grupet parlamentare janë kthyer në pronë private nga shefat e këtyre grupeve. "Një lajm për gazetarët që përcjellin Kuvendin. Ju ish-kolegët e mi të vjetër që e përcillni


Kuvendin e Republikës së Kosovës, ju që gjithë ditën lodheni e stërlodheni duke punuar në kushte tepër të vështira, pa shkoni e pyeteni kryetarin Kadri Veseli se si ka mundësi që Kuvendi paguan 6 000 euro në muaj vetëm qira për makina (jashtë shpenzimeve) për makina të dedikuara për grupet parlamentare, por që shefat e këtyre

grupeve, duke përfshirë edhe atë të Nismës, i kanë kthyer në pronë private. I vetmi grup parlamentar që ka punësuar një shofer dhe që makina përdoret për nevojat e deputetëve të grupit është ai i LVV-së. P. sh., Avdullah Hoti e vozit vetë dhe e shfrytëzon vetë. Njësoj vepron edhe Bilall Sherifi, bashkë me të tjerët", ka shkruar Zeka në llogarinë e vet në

"Facebook". Sipas tij, kjo që po ndodh është për keqardhje. "Kuvendi nuk 'ka' para për nga një laptop, ku 50 mijë euro harxhohen në vit për fotokopje, a paska 72 000 euro në vit vetëm për këto makina shtesë që të paguajë qira, a si deputet nuk kemi fond qoftë edhe për një gazetë ditore! Me thënë marre, pak është!", ka theksuar Zeka.



# PSE MENDOJ SE FATMIR XHAFAJ GABOI KËSAJ HERE



Nga Bedri ISLAMI

Dorëheqja e ministrit të Punëve të Brendshme, Fatmir Xhafaj nga detyra e tij, mëngjesin e së shtunës, ishte ngjarja më e papritur politike e mandatit të dytë qeverisës së kabinetit Rama. Nuk e di pse jam i bindur se pak ditë më parë një dorëheqje e tillë as që mendohej, ashtu si mund të marr me mend se çfarë stuhish duhet të jenë ngritur në orët e fundit para largimit të tij.

Pak ditë më parë, përmes mesazheve me zotën Xhafaj, kishim lënë mundësinë e një takimi të shpejtë, si një çështje kohe, por edhe përmes rreshtave askush nuk mund të lexonte se ai po përgatitej për një largim të mundshëm. As ai vetë nuk mund ta kuptonte, sepse nuk ekzistonte një mundësi e tillë.

Megjithatë, dorëheqja ndodhi. Nën trysinë e politikës opozitare nuk besoj të ketë ndodhur. Sepse, pas sukseseve të fundit të këtij dikasteri, edhe opozita më budallaqe do ta kishte kuptuar se, duke luftuar kundër këtij ministri, në fakt ato po luftonin me mullinjtë e erës, ndoshta edhe më keq, ata do të dëshmonin se, duke qenë kundër njeriut që përmbysi shumë tabu në Policinë e Shtetit dhe ndaj të "fortëve", ata bëheshin palë me këto të fundit.

Nuk besoj se është ndjerë i lodhur nga gjithë kjo që po ndodhte rreth tij, emrit të tij dhe familjes së gjerë. Nëse do të kishte pasur lodhje, ajo mund të kishte qenë në një kohë tjetër, ose ndoshta nuk do të ishte ripranuar detyra e tij në rikthimin e postit të ministrit pas zgjedhjeve të vitit të shkuar. Periudha që kanë rendur para dorëheqjes kanë qenë shumë

më të rënduara në secilën ditë dhe kanë pasur një intensitet të tillë sa që do të kishin mjaftuar për të shkarkuar disa ministra që nuk do të kishin karakter dhe besim në detyrën e tyre. Ai i përballoi, megjithëse kurban i kishte qenë i rëndë. Ndonëse nuk e kërkonte më vendi ku ishte dënuar, me të drejtë apo jo, dërgoi vëllanë drejt një riburgimi, i cili nuk do të jetë edhe aq i shkurtër.

Në të gjitha rastet ai shfaqti qetësinë e një drejtuesi fjalë-pakë, ndërsa tani, kur sapo kishte filluar të ndjellte frutet e një pune të saktë, ai largohet. Enigma është e pranishme, nuk dihet se sa do të zgjasë heshtja e tij, por një e vërtetë mbetet: largimi i tij, edhe po të ishte i paralajmëruar, ishte i gabuar.

Pse mendoj se Fatmir Xhafaj gaboi kësaj here?

Në 28 vjet jetë plurale ai ishte ministri më i suksesshëm i cili krijoi në pak kohë profilin e një ministri ndryshe, aspak militant, i zhveshur nga ndikimi i grupeve dhe i pranishëm së forcës që e kishte deleguar në atë post të rëndësishëm; i gatshëm që të krijonte një elitë të re drejtuese, duke zhvendosur pa dhimbje njerëzit që kishin mbi punën e tyre një enigmë të shkuar, ndaj sposito në 10 qarqe drejtorët e policisë, i ndërjegjshëm se puna e tij ishte e vështirë, por mund të realizohej nëse koncepti i drejtë dhe vizioni për ndërlidhjen e re mes strukturave të ligjit do të ishte primar. Xhafaj erdhi në këtë detyrë duke pasur një besim të pashoq nga partnerët ndërkombëtarë; edhe kur ata ishin larg, si agjencitë ligjzbatuese të ShBA-së, por edhe institucionet e rëndësishme evropiane që monitorojnë politikën e sigurisë në Shqipëri. Megjithëse ai u ndodh, si kurrë më parë, përballë një presioni të jashtëzakonshëm politik të opozitës, e cila ngriti dhjetëra akuza ndaj tij, në asnjë rast, askurrë, ata nuk u mbështetën nga institucionet e rëndësishme ndërkombëtare. Ministri Xhafaj dhe qytetari Xhafaj vazhdonte të kishte mbi

vete këtë mantel mbrojtës ndërkombëtar.

Në fakt, në të gjithë qeverinë Rama, ndoshta edhe më mirë nga Rama vetë, Xhafaj ishte jo vetëm shtetas, por edhe burrë shteti. Ai i njihte strukturat shtetndërtuese dhe shtetzhvilluese më mirë nga gjithë ekipi tjetër, i cili kishte ardhur befasi në politikë e, po aq befasi, një mëngjes e kishte ndjerë veten anëtar i një qeverie të majtë. Ndoshta që këtu fillon edhe kontradikta e tij me ekipin, pjesë e së cilës ishte, e ndoshta, edhe me vetë shefin e qeverisë. Jo më kot ekzistonte mendimi se, "nëse Edi Rama bie, atë mund ta zëvendësojë Fatmir Xhafaj, por nëse bie Xhafaj, atë nuk e zëvendëson dot Edi Rama".

Largimi i Xhafaj është dashur me ngulm nga opozita. Nga e gjithë struktura e saj politike. Ishte një drojë e pazakontë e opozitës ndaj emërimit të tij, ashtu si është tani një gëzim i papërmbajtur.

Opozita nuk e desh Xhafaj jo se ai kishte një foto në tribunë me ish liderin e një kohe tjetër, pasi ajo vetë drejtohej nga një gërmadhë politike që kishte ëndërruar për një foto të tillë, apo që as duart nuk i lante pas një shtrëngimi me Hoxhën.

Opozita nuk e desh Xhafaj jo se ai kishte qenë edhe më herët ministër i Drejtësisë dhe kishte qenë ndryshe nga ministrat e saj të drejtësisë që bëheshin, si mos më keq, lolo në duart e një birboje plëngprishës. Opozita drejtohej nga një urdhërdhënës për katër vrasje.

Opozita, duke e filluar lojën e saj nga Nishani president, i cili ngriti stekën e lojës deri në sajime të përcudshme politike, megjithëse do të ishte i detyruar ta dekretoje, bëri kauzë të saj çështjen Xhafaj për dy arsye themelore: ai kishte qenë drejtuesi i Komisionit të Posaçëm për ndryshimet kushtetuese që lidhen me reformën në drejtësi dhe, së dyti, sepse e dinin se tani kishin të bënin me një shtetar, njohës të mirë të ligjeve, që nuk mund

ta përkulnin.

Megjithatë, Fatmir Xhafaj, u tërhoq.

U tërhoq në vitin kur mbjellja e narkotikëve, Cannabis sativa, është në rekordin minimal të mundshëm dhe kur nga harta e dikurshme kanë mbetur vetëm disa njolla, gjë që nuk mund të imagjinohej pak muaj më parë. Asnjëherë në këto vite nuk ka pasur një pakësi të tillë mbjelljesh dhe kaq shumë goditje paraprake, të cilat, sido që të jetë, e zhdukën Shqipërinë nga harta e vendeve kultivuese të hashashit.

Këtë nuk e kishte arritur askush.

Çmitizimi i të fortëve, edhe kur ata janë të lidhur fort me politikën, ishte shfaqja tjetër e një Policie ndryshe dhe e një drejtuesi të pajalë.

Goditjet e ditëve të fundit, jo të pakta, por as edhe të fundit, u bënë ndaj disa grupeve që mendohej se kishin lidhje me politikën. Të grupeve që mendonin se e kishin të garantuar paprekshmërinë e tyre. Që mendonin se ishin bërë partnerë me politikën dhe se kjo e fundit varej prej saj. Këto banda të "të fortëve", pjellë e pushtetit të vitit 1996 e vazhdim i mëtejshëm, kishin krijuar staturën e tyre dhe kishin krijuar mendësinë, edhe tek të tjerët, se ishin një pushtet i dytë.

Fillimi i goditjes së tyre, në disa zona të përvëlura nga nxehtësia e politikës, si në Shkodër, në Durrës, në Elbasan ngjalli panikun dhe nga ky panik shumë do të jenë trembur.

Njeriu që paralajmëroi se e gjithë kjo ishte fillesa e goditjes, tani, befasi, kur askush nuk e mendonte, u tërhoq.

Dorëheqja e tij u pranua vetëtimthi. Nënshkrimi i një ministri tjetër, po ashtu, i cili mund të jetë dhe besoj të jetë, po aq i devotshëm dhe shtetar i mirë.

**Kush e detyroi Xhafaj të tërhiqej?**

**Janë tri mundësi:**

Së pari, shefi i qeverisë, Edi Rama. Shkaqet mund të gjenden mes tyre. Është naive të

mendohet se dorëheqja e Xhafaj është bërë në një çast shpërthimi. Ai është shtetar. Ka të ngjarë që statura politike në rritje e Xhafaj, të ishte në radhët e vetë partisë së tij një greminë më shumë. Dëshira për të bërë ligjin edhe brenda kupolës së tij, shtrirë në degëzime, një greminë tjetër. Ai po lëvizte përmes tyre. Kjo mund të ishte e duartrokitur për njerëzit, por jo për liderët. Jo për ata që i rrethojnë liderët. Sidomos jo për këto të fundit. Më të shumtë, jo anonimë. Ndodh edhe kështu. Shefi i qeverisë, ashtu i rrëmbyeshëm si është, mund të ketë dëgjuar zërat jashtë qeverisë për të bërë një lëvizje brenda qeverisë.

Së dyti, grupet që mund të jenë të listuara për goditje të kenë ndërmarrë revanshin e tyre. Vangjushi mund të jetë njëri prej tyre. Dosjet e prokurorisë nuk janë tabu. Ata, më parë se të shkojnë në gjykatë, vazhdojnë të shkojnë në opozitë. Nëse ka ndodhur kjo, atëherë do të ishte gjëja më e dhimbshme dhe dëshmi se shteti duhet të ringrihet.

Duhet pranuar se grupet kriminale në Shqipëri, aq sa ishin të lidhura me PD-në në kohën e sundimit të saj, aq lehtësisht mund të shkojnë majtas. Nëse ata kanë ndjerë rrezikun e fatit të Bajrëve, të grupit të Shijakut apo të asaj që mund të ndodhë rreptë në Elbasan e gjetkë dhe, kanë pasur forcën të veprojnë e të rrezojnë një ministër, atëherë ballafaqimi nuk do të jetë i largët. Gjoshi mund të rrezojë përkohësisht një ministër, por nuk ndryshon gjithçka.

Së treti, strukturat jashtë Shqipërisë kanë menduar se është koha e një ndryshimi, duke sjellë në drejtimin e dikasterit, përsëri një njeri të besuar të tyre, i cili, veç shkollimit ushtarak, ka edhe trajtim të veçantë në shkollat e sigurisë. Bile, të një niveli të lartë. Kjo e fundit do të ishte më lehtësuesja, por që ka ndodhur një shkëmbim rolesh mesnatën e së premtes, kjo u bë e ditur të shtunën në mëngjes.



Republika e Kosovës përfaqësohet për herë të parë në Samitin e Investimeve në Azi

# Interesim i madh i bizneseve të huaja për investime në Kosovë

Një delegacion i Kosovës nga Ministria e Punëve të Jashtme ka përfaqësuar vendin për herë të parë në Samitin e Investimeve, i cili është mbajtur në Kuala Lumpur të Malajzisë. Drejtori i Komunikimit dhe Diplomacisë Publike, Sami Kastrati, ka bërë me dije se Kosova mbetet vendi më atraktiv për të bërë biznes në sektorë të ndryshëm



EPOKA ERE

Qendresa RAMA

**PRISHTINË, 28 TETOR** - Një delegacion i Republikës së Kosovës nga Ministria e Punëve të Jashtme, i udhëhequr nga drejtori i Komunikimit dhe Diplomacisë Publike, Sami Kastrati, në përbërje të të Ngarkuarit me Punë në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Australi, Mehmet Morina dhe zyrtarit të lartë nga Departamenti i Diplomacisë Ekonomike, Turkesh Dalifi, kanë përfaqësuar vendin për herë të parë në Samitin e Investimeve, i cili është mbajtur në Kuala Lumpur të Malajzisë.

Samiti njëditor, me pjesëmarrje të kompanive të shumta nga shtete të ndryshme të Azisë në përgjithësi dhe Azisë Juglindore në veçanti, duke përfshirë Korin Diplomantik të akredituar në shtetin e Malajzisë, prezantoi disa shtete të ndryshme të botës, të cilat vlerësohen me potenciale të mëdha zhvillimi, ndërsa nga kontinenti i Evropës, Kosova ishte vendi i vetëm pjesëmarrës.

Veç kësaj, Kosova u prezantua si vendi i parë në Samit nga shtetet e tjera pjesëmarrëse. Me këtë rast, para të pranishmëve, drejtori i Komunikimit dhe Diplomacisë Publike, Sami Kastrati, fillimisht ka bërë një

prezantim të zhvillimeve të përgjithshme në Kosovë dhe rajon, më pas ka ofruar argumentet se pse shteti i ri duhet të jetë vend atraktiv për investime nga shtetet e Azisë Juglindore. "Fakti që ne jemi këtu sot është dëshmia më e mirë se vendi ynë i kushton një rëndësi të veçantë Investimeve të Huaja Direkte (IHD). Ne jemi këtu për t'i prezantuar mundësitë e bizneseve që ofron vendi ynë, t'ju asistojmë juve në këtë drejtim, t'ju përcjellim ftesën e sinqertë për investime dhe ta tregojmë përcaktimin dhe përkushtimin tonë të fuqishëm se Kosova është gati për ju", ka thënë Kastrati.

Ai ka shtuar se Kosova është vendi më i ri, me popullatën më të re në Evropë, i vendosur në një lokacion strategjik, me ekonomi liberale të tregut. "Kosova ka Marrëveshje për Stabilizim Asociim me BE-në, atë të CEEFTA-s, Marrëveshje Preferenciale të Tregtisë me ShBA-në, Japoninë dhe Norvegjinë, ka ambient miqësor dhe konkurrues të biznesit, sistem të shëndoshë ekonomik, taksa të ulëta, fuqi punëtore të lirë dhe të kualifikuar", është shprehur ai, duke renditur më pas sektorët më atraktivë për investime në vend. "Nga pikëpamja jonë, Kosova mbetet vendi më atraktiv për të bërë biznes dhe për të investuar në vendet e Ballkanit

Perëndimor dhe ekzistojnë sektorë të mjaftueshëm: nga bujqësia dhe paketimi i ushqimit tek minierat dhe energjia; nga ndërtimet e infrastrukture te përpunimi i drurit; nga teknologjia informative, telekomunikacioni dhe tekstili deri te përpunimi i lëkurës", ka thënë ai.

Në vazhdim janë prezantuar të arriturat e gjithëmbarshme të vendit në aspektin politik dhe ekonomik, që nga shpallja e pavarësisë si në nivelin kombëtar, po ashtu edhe atë ndërkombëtar.

Gjatë prezantimit janë paraqitur si argumente për investime stabiliteti financiar i Kosovës, reformat e ndërmarra ekonomike, duke përfshirë miratimin e Ligjit për Investime

Strategjike, atij për partneritetet publiko-private, themelimi i zonave të lira të ekonomike, infrastruktura moderne, që e lidh vendin me vendet fqinje dhe qasja më e lehtë dhe më e shpejtë në tregun e Evropës, rritja e qëndrueshme ekonomike, e cila për këtë vit është paraparë të jetë më shumë se 4 për qind dhe e dyta në rajon; borxhi më i ulët publik në rajon; raporti i të bërit biznes i Bankës Botërore, e cili e rendit Kosovën në vendin e 40 dhe indikatorë të tjerë ekonomikë. "Duke vlerësuar faktet dhe statistikat e treguara më lart, vlerësimet pozitive mbi performancën ekonomike të Kosovës nga organizata kredibile ndërkombëtare është pikëpamja jonë se ekzistojnë shumë

arsye, që ta shihni dhe të keni besim në Kosovën, si një qendër të Azisë Juglindore në Ballkanin Perëndimor dhe si një urë lidhëse për të pasur qasje në tregun shumëmilionësh të Bashkimit Evropian", ka thënë Kastrati.

Pas prezantimit të Kosovës dhjetëra biznese dhe fondacione kanë takuar delegacionin e Republikës së Kosovës, duke shprehur interesimin për investime konkrete nga energjia e ripërtëritshme si ajo solare dhe me erë, në tekstil, telekomunikacion, atë bankar dhe sektorë të tjerë. Pjesëmarrja e Kosovës në Samitin e Investimeve në Malajzi u mundësua dhe organizua nga Ambasada e Republikës së Kosovës në Australi.

## Pensionet rriten nga 15 deri 34 euro në muaj



**PRISHTINË, 28 TETOR** - Rritja e pensioneve është paralajmëruar publikisht gjatë një takimi të zhvilluar ndërmjet ministrit të Financave, Bedri Hamza, kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli dhe përfaqësuesve të Lidhjes së Pensionistëve.

Nisur nga deklaratat e bëra pas atij takimi, Hasan Berisha, sekretar në Lidhjen e Pensionistëve të Kosovës, ka thënë se tashmë dihen edhe përqindjet e premtu-

ara për rritje. "Ministri i Financave ka konfirmuar se rritja e pensioneve ka hyrë në kuadër të buxhetit 2019. Për pensionet e pleqërisë, të cilët kanë marrë 75 euro pensionet, vitin tjetër pensioni do të rritet për 20 për qind. Ndërsa për pensionet kontributpagues shuma mujore do të rritet për 15 për qind. Baza e pensionit kontributpagues është 158 euro deri në 240. Ne jemi të kënaqur me një hap të tillë, edhe pse është

një korrigjim i vogël, por i domosdoshëm, sepse pensionet në periudhën e pasluftës nuk kanë qenë ekuivalente me meritat", ka theksuar Berisha.

Sipas një përlllogaritje ende jozyrtare, i bie se pensionet e pleqërisë, ata që marrin nga 75 euro aktualisht, me buxhetin e ri do të marrin 90 euro. Kurse pensionistët kontributpagues nga shuma prej 230 eurove do të marrin 34 euro më shumë në muaj.

## Jashari: E dua Skenderajn me hapjen e fabrikave

SKENDERAJ, 28 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari dhe nënkryetari Nuredin Lushtaku, kanë vizituar ndërtimin e fabrikës private në Klinë të Epërme, në të cilën do të prodhohet "EPS Stiropori", një investim milionësh i firmës "ADIFIX".

Kryetari Jashari, pas vizitës, ka thënë se e dëshiron Skenderajn me hapje të fabrikave, të zhvilluar, me zbutje të papunësisë, varfërisë dhe investime në sektorin privat. "Këtë ditë pushimi shfrytëzoj ta vizitoj së bashku me nënkryetarin Nuredin Lushtaku, fabrikën e firmës 'ADIFIX', ku do të prodhohet materiali për ndërtimë më i kërkuar në treg, ai i stiroporit.

Përfaqësuesve të firmës u urova fillim të mbarë për investimin milionësh në ngritjen e kësaj fabrike, në të cilën do të punësohen së paku 20 punëtorë, që me të ardhurat që do të sigurojnë nga puna në fabrikë, do t'i mbajnë familjet. Komuna e Skenderajt, nën udhëheqjen time, do të ofrojë mbështetje në të gjitha aspektet, lehtësira dhe përfitime të tjera për secilin investitor, qoftë i huaj apo vendor", është shprehur Jashari. Fabrikat si ajo e firmës "ADIFIX", por jo vetëm, e cila po ndërtohet aktualisht, e që në muajin mars të vitit të ardhshëm pritet ta fillojë prodhimin e stiroporit, mund ta bëjnë Skenderajn të zhvilluar ekonomikisht e të përparuar.



## Heroi Rasim Kiçina së shpejti bëhet me shtatore

DRENAS, 28 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka bërë me dije se ka filluar të përjetësohet në bronz figura e heroit të kombit, Rasim Kiçina. Ai ka thënë se shtatorja e Kiçinës do të vendoset në Drenas për ta kujtuar amanetin e tij se si punohet për atdhe. "Heroi ynë, Rasim Kiçina, tashmë ka filluar të përjetësohet në bronz. Sot, së bashku me

familjarët e tij dhe me shokët, Ardianin dhe Flamurin, vizitua vendpunishten ku po realizohet shtatorja që i mungon Drenasit dhe Drenicës. Ashtu siç duhet, në Drenas, Rasim Kiçina do të flasë me shekujt, me mesazhin se si jetohej dhe luftohej për atdhe. Falënderoj donatorët, të cilët pa kursim mbështesin iniciativën të përjetësimit të heronjve tanë në

sheshet e Drenasit dhe Drenicës, duke i bërë ata të gjallë, çdo ditë në mesin tonë, për të na kujtuar amanetin e tyre se duhet të punojmë për atdheun deri në sakrificë. Falënderoj skulptorët Ylberin dhe Sabriun të cilët po e rikthejnë në mesin tonë, me dimensionin heroik, Rasim Kiçinën!", ka shkruar Lladrovci në llogarinë e vet në "Facebook".

# Hetimet tremujore të policisë rezultojnë me arrestimin e disa trafikantëve të drogës

Policia e Kosovës në dy raste ka arrestuar pesë persona për përfshirje në veprën penale "blerje, posedim dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge" dhe ka konfiskuar një sasi lëndësh që dyshohet të jenë narkotikë



dyshuar (banesë e shfrytëzuar bashkërisht nga të katër të dyshuarit) janë gjetur: 14 pake-

time me të mëdha me marijuanë me peshë 718.1 gramë, një paketim me marijuanë

peshë 1 006 gramë, një paketim me marijuanë me peshë prej 503.4 gramësh si dhe 153 qese të vogla të mbushura me narkotik të llojit marijuanë, të gatshme për shitje me peshë prej 234.8 gramësh, dy peshore elektronike, rreth 200 qese të zbrazura sikur ato të cilat janë paketuar narkotikët për shitje, pasaporta e personit të dyshuar, shtetas i Shqipërisë, si dhe një fletore me shënime për shitje të narkotikëve. "Të gjitha këto dhe veturat e të dyshuarve janë konfiskuar. Pas intervistimit të personave të dyshuar, me vendim të prokurorit të krimeve të rënda, ata dërgohen në qendrën e mbajtjes", është theksuar në komunikatën e Policisë.

Po ashtu, nga njësia e njëjtë policore, më 26. 10. 2018, pas marrjes së lejes nga organet e drejtësisë, është kontrolluar banesa në Prishtinë e një të dyshuarit, B. M., viti i lindjes 1975. Aty janë gjetur dhe konfiskuar 1 101 gramë substancë narkotike, dyshohet të jetë heroinë dhe rreth 9 gramë substancë që dyshohet të jetë marijuanë. I dyshuari, me vendim të prokurorit, dërgohet në mbajtje.

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 28 TETOR - Drejtoria për Hetimin e Trafikimit të Narkotikëve - Njësia Prishtinë, ka zhvilluar një hetim rreth tremujor kundër një grupi të personave të dyshuar për përfshirje në veprën penale: "Blerje, posedim dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge". Më 27. 10. 2018 njësitë i antidrogës, i ndihmuar edhe nga Njësia për Reagim të Shpejtë, ka planifikuar arrestimin e personave të dyshuar. "Në orën 21:00, në rrugën Prishtinë - Mitrovicë, ka ndaluar veturën me targa vendore në të cilën ndodheshin katër persona. Të dyshuarit që gjendeshin në veturë ishin: F. R., viti i lindjes 1990; A. H., viti i lindjes 1989; K. B., viti i lindjes 1998 dhe A. I., viti i lindjes 1998.

Gjatë kontrollit të veturës janë gjetur dy qese me narkotik të llojit marijuanë me peshë prej 3.3 gramësh dhe një shufër metalike. Gjatë kontrollit trupor tek i dyshuari F. R. janë gjetur pesë qese me bari ngjyrë të gjelbër, e dyshuar si marijuanë, me peshë prej 7.4 gramësh dhe 50 euro para të gatshme. Tek i dyshuari A. H. janë gjetur dymbëdhjetë qese me narkotike të llojit marijuanë me peshë prej 17.6 gramësh dhe para të gatshme në vlerë prej 70 eurosh. Tek i dyshuari K. B. janë gjetur 200 euro para të gatshme, të gjitha nga pesë euro, që dyshohet të jenë fituara nga shitja e narkotikëve", është thënë në komunikatën e Policisë së Kosovës.

Më tej thuhet se në konsultim me prokurorin kujdestar dhe me urdhër verbal të GjPP-së është bërë kontrollimi i shtëpisë së të dyshuarit F. R. dhe në banesën e personave të



## Mattis: Pentagoni po shqyrton dislokimin e trupave në kufi me Meksikën

WASHINGTON, 28 TETOR - Sekretari amerikan i Mbrojtjes Jim Mattis tha se zyrtarët e Pentagonit po përpunojnë ende detajet mbi dislokimin e disa qindra trupave në kufirin jugor të Shteteve të Bashkuara, pasi një karvan emigrantësh vazhdon rrugën e tij përmes Meksikës drejt Shteteve të Bashkuara.

Mattis foli me gazetarët që udhëtonin me të për në Pragë. Të premtën, Pentagoni miratoi një kërkesë nga Departamenti i Sigurisë Kombëtare për të dërguar qindra trupa në kufirin SHBA-Meksikë në atë që cilësohet si një rol mbështetës. Në një deklaratë të publikuar të premtën thuhet se personeli do të mbështesë

patrullën kufitare me ndihmën e planifikimit, ekupe mjekësore dhe ndërtimin e strehimit të përkohshëm, së bashku me detyrat e tjera mbështetëse. Ata do të bashkohen me më shumë se 2,000 anëtarë të Gardës Kombëtare tashmë të vendosur në zonë që po japin mbështetje për agjentët e patrullimit kufitar.



## OKB, 73 vjet në funksion të paqes dhe sigurisë në botë

ShBA-ja dhe Britania e Madhe u bënë nismëtare për krijimin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) të cilët në pikën e 11 të Kartës së Atlantikut, të nënshkruar më 14 gusht 1941, që përmbante principet bazë mbi rendin e ri botëror të ardhshëm, ranë dakord që pas luftës do të krijohet një sistem i vazhdueshëm i sigurisë së përgjithshme

NYU JORK, 28 TETOR - Nismëtarët e krijimit të OKB-së u bënë fuqitë e mëdha të koalicionit antifashist, Shtete të Bashkuara të Amerikës dhe Britania e Madhe, të cilët në pikën e 11 të Kartës së Atlantikut të nënshkruar më 14 gusht 1941 dhe që përmbante principet bazë mbi rendin e ri botëror të ardhshëm, ranë dakord që pas luftës do të krijohet "një sistem i vazhdueshëm i sigurisë së përgjithshme".

Në Deklaratën e 1 janarit 1942, e

nënshkruar nga përfaqësuesit e 26 shteteve të koalicionit antifashist dhe antinazist u ritheksua nevoja për vendosjen e një paqeje të qëndrueshme që do t'u siguronte kombeve mundësinë për të jetuar të sigurt brenda kufijve të tyre. Ideja e krijimit të një organizate të re universale dhe emërtimi "Kombet e Bashkuara", u rimor në shqyrtim në Konferencën e Ministrave të Punëve të Jashtme të SHBA, ish-Bashkimit Sovjetik dhe Britanisë së Madhe, që u

zhvillua në Moskë me 19 deri 30 tetor të vitit 1943. Në Deklaratën mbi Sigurinë e Përgjithshme që u nënshkrua më pas edhe nga Kina, u formulua për herë të parë vendimi mbi krijimin e Organizatës Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara. Ndërsa parimet, struktura dhe funksionet e organizatës u formuluan në Konferencën e Dumbarton Oaks që u zhvillua nga 21 gusht deri më 29 shtator të vitit 1944, në të cilën morën pjesë përfaqësuesit e ShBA-së, ish-Bashkimit Sovjetik, Britanisë së Madhe dhe Kinës. Konferenca përpunoi dokumentin e quajtur "Propozime për krijimin e organizatës ndërkombëtare të sigurimit të përgjithshëm". Në shkurt 1945 u mbajt Konferenca e Jaltës, në Krime, me pjesëmarrjen e Franklin Ruzvelt,

Stalin dhe Churchill. Ajo hodhi bazat politike të të gjitha bisedimeve për paqe pas përfundimit të luftës. Në këtë konferencë u ridiskutua dhe u ra dakord përfundimisht për krijimin e OKB-së si një organizatë ku mund të bënin pjesë kombe të mëdhenj e të vegjël. ShBA-ja thirri Konferencën e San Franciskos, ku do të merrnin pjesë të gjithë shtetet që i kishin shpallur luftë Gjermanisë naziste deri në mars 1944. Konferenca e San Franciskos i zhvilloi punimet e saj nga 25 prilli 1945 deri më 26 qershor të vitit 1945. Ajo pranoi dështimin e Lidhjes së Kombeve për pengimin e Luftës së Dytë Botërore. Me 26 qershor 1945 u miratua Karta e Kombeve të Bashkuara, e cila hyri në fuqi më 24 tetor 1945. Kjo datë u shpall si Dita Ndërkombëtare e OKB-së.

## Në Brazil janë mbajtur zgjedhjet presidenciale

BRAZILI, 28 TETOR - Votuesit në Brazil të dielën kanë votuar për të zgjedhur presidentin e ri të vendit. Vëzhguesit thonë se zgjedhjet mund t'i fitojë një kandidat i ekstremit të djathtë. Kundërshtarët thonë se fitorja e tij do të kërcënonte një nga demokracitë më të mëdha në botë.

Kongresisti brazilian Jair Bolsonaro, kandidati presidencial që sondazhet e nxjerrin në epërsi në zgjedhjet e sotme, është quajtur "Trumpi Tropikal" për qasjen e tij luftarake, pikëpamjet përçarëse dhe qëndrimet e tij kundër elitës politike. Një ish-komandant i ushtrisë, Bolsonaro është kritikuar gjithashtu për lëvdatat e tij për diktaturën ushtarake të Brazilit dhe për komentet fyese ndaj homoseksualëve, afrikano-brazilianëve dhe grave. Mesazhi i Bolsonaros është se Brazili është bërë një shtet jofunksional dhe se një udhëheqje e fortë nga një person jashtë sistemit aktual politik është i nevojshëm për të rivendosur rendin. Gjatë fushatës, ai shkaktoi protesta pas komenteve se gabimi kryesor i diktaturës ushtarake ishte se nuk vrau më shumë njerëz dhe se nëse zgjidhet president, ai do të mbyllte Kongresin Kombëtar të Brazilit. Diktatura ushtarake në Brazil ka qeverisur vendin nga viti 1964 deri në vitin 1985, kur vendi bëri një transicion drejt demokracisë. Gjatë kësaj periudhe ushtria u akuzua për ekzekutimin, torturimin e kundërshtarëve, dhe shtypjen e disidentëve në emër të parandalimit të përhapjes së komunizmit.



## Rusia do t'i përgjigjet ShBA-së lidhur me shqetësimet për Traktatin

MOSKË, 28 TETOR - Ministri i Jashtëm rus, Sergei Lavrov thotë se Moska është duke draftuar përgjigjet të një liste pyetjesh, që së fundmi janë paraqitur nga Shtetet e Bashkuara, që kanë të bëjnë me shqetësimet lidhur me marrëveshjen për armë bërthamore. Gjatë një interviste për një televizion rus, Lavrovi tha se këshilltari për siguri kombëtare i ShBA-

së, John Bolton i ka paraqitur shqetësimet lidhur me traktatin për forcat bërthamore me kapacitet të mesëm, gjatë takimit të tij me presidentin rus, Vladimir Putin më 23 tetor. Teksa ShBA-ja po kërcënon se do të tërhiqet nga Traktati për Armë bërthamore, Lavrovi tha se "fati i traktatit New START është i paqartë". Marrëveshja për armët

bërthamore ishte nënshkruar më 1987 dhe ka për qëllim të eliminojë raketa tokësore balistike dhe raketat detare, që arrijnë gjatësinë nga 500 deri 5,500 kilometra. Traktati New START kufizon armët strategjike bërthamore. Ky pakt ishte nënshkruar më 2010 dhe pritet të skadojë më 2021, edhe pse dy palët pajtohen se traktati mund të zgjatet edhe për një periudhë pesëvjeçare.



# Udhëtimi me tren, zbuloni hekurudhat më piktoreske në botë



## Dhjetë vende në planet, ku binarët ofrojnë një përvojë magjike

Treni dikur konsiderohej një mënyrë e shpejtë dhe e sigurt për të udhëtuar. Sot, siguria mbetet, por ky mjet transporti ofron shumë ide për ata që mbështesin udhëtimin e ngadalshëm. Sigurisht që ofron përvoja dhe pikëpamje të pazakonta, shumë të vlerësuar nga udhëtarët më të vëmendshëm dhe jo shumë të nxituar. Këtu janë dhjetë hekurudha historike që ofrojnë pikëpamje magjepsëse dhe defintivisht jashtë së zakonshmes.

**GLACIER EXPRESS – ZVICËR** – Ndoshta është një nga rrugët më të bukura të trenit në botë dhe një vend i Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s. Pavarësisht se është treni më i ngadalshëm në botë (me një shpejtësi mesatare prej 33 kilometrash në orë) mbulon 270 km në malet që ndajnë Zermatt dhe St. Moritz, duke marrë pothuajse tetë orë. Treni kalon 91 tunele dhe 291 ura.

**ORIENT EXPRESS** – Është princi i



trenave dhe një ikonë e luksit dhe misterit, e dashurisë dhe e spiunazhit. Makinat e saj ikonike kanë pritur James Bond, ishin skena e vrasjes së famshme të Agatha Christie dhe, gjatë viteve të Luftës së Ftohtë, ata ishin një nga lidhjet e pakta mes botës perëndimore dhe lindore. Treni sot quhet Venice-Simplon Orient Express dhe, restauruar plotësisht, lidh Londrën me Venedikun, me disa ndryshime të itinerarit, gjithnjë në emër të luksit më ekskluziv.

**CALEDONIAN SLEEPER – BRITANI E MADHE** – Fillon nga Londra dhe mbërrin në

Highlands Skoceze, në Fort William, pas 13 orësh dhe mbi 819 kilometra udhëtimesh. Rruga është një magji e plotë, midis peizazheve të bukurosis intensive dhe një shërbimi të klasit të lartë në bord.

**OSLO-BERGEN – NORVEGJI** – Treni daton në shekullin e 19-të dhe kalon malet, fjordet dhe pyjet. Në rreth gjashtë orë e gjysmë ju mund të admironi peizazhet e pakrahasueshme natyrore, të gjitha për t'u shijuar me hundën ngjitur në dritare.

**MOUNTAINEER ROCKY – KANADA** – Një itinerar i shkëlqy-

er për të admiruar nga dritaret panoramike të makinave turistike të veçanta. Treni kalon Jasper Park Natyror, një Trashëgimi Botërore e UNESCO-s në zemër të Rockies Kanadeze, duke përfshirë liqene, ujëvara dhe akullnaja. Përjetimet e veçanta me drejtë kafshë të tjera të egra nuk janë të pazakonshe.

**FIANARANTSOA-MANAKARA-MADAGASKAR** – Hekurudha kalon pjesën juglindore të ishullit dhe daton në fillim të shekullit të njëzetë. Është një mënyrë aventureske dhe e pazakontë për të eksploruar këtë pjesë të vendit, të mbuluar me bimësi të harlisur. Udhëtimi nuk është i përshtatshëm për ata që nxitojnë: treni ka një shpejtësi kërmilli dhe zgjat rreth 12 orë për të udhëtuar 160 km.

**GHAN – AUSTRALIA** – Ky karvan, një nga më luksozët e kontinentit, sjell turistë të eksplorojnë zemrën e vendit. Udhëtimi zgjat dy ditë, nga Adelaide (në bregun jugor) deri në Darwin në veri. Pista kalon pothuajse 3 mijë kilometra të outback, shkretëtirën australiane, në mes të peizazheve shumë të ndryshme dhe unike në botë.

**'THE REUNIFICATION EXPRESS' – VIETNAM** – Treni udhëton 1726 kilometra që ndan Ho Chi Minh City nga kryeqyteti i Vietnamit, Hanoi, në dy ditë udhëtimi mes brigjeve të mrekullueshme, qyteteve historike dhe personazheve kuriozë që janë të shpeshta për t'u takuar në bord. Në Hanoi, treni kalon nëpër një rrugë të gjatë dhe të ngushtë të banuar, duke kaluar pranë shtëpive.

**TRANZALPINE – ZEALANDA E RE** – Kjo hekurudhë historike lidh Christchurch me Greymouth dhe në rreth pesë orë kalon të gjitha zonat klimatike të Ishujve të Jugut. Pamjet panoramike janë të mëdha, me male dhe brigjet, liqene dhe kodra, të cilat na vijnë përmes frontit të dritares.

**PEKIN-LHASA – KINË** – Ashtu si çdo gjë që lidhet me Kinën, dimensionet janë të mëdha: 3750 km dhe 40 orë udhëtimi me një rënie vertikale prej më shumë se 5000 metra, përmes peizazheve më të ndryshme: nga arkitekturat perandorake të kryeqytetit të Kinës, maleve dhe në manastiret e Lhasa, në Tibet. (gazeta-Shqip.com)

E jashtëzakonshme

## Robotët policë që "kapin" keqbërësit para veprimit

Duhej pritur që, për tema të tilla, siguria do të kalonte edhe përmes robotëve. Ata që tashmë janë në përdorim në 16 shtete amerikane, janë programuar të kuptojnë atë që bëjmë, ku shkojmë dhe cilat synime kemi. Ata patrollojnë pa u ndalur, madje edhe nën mot të keq, aeroporte,



parkingje, rrugë, por edhe qendra tregtare, shtëpi dhe vila të mëdha.

## BARSOLETA E DITËS



Një njeri që kishte pirë alkool, e shkeli një polic me veturë dhe e thirri policinë menjëherë:  
- Alo, a jeni ju 192?  
- Po.  
- E tash jeni 191.



## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

### "ALPHA" 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson  
Regjia: Albert Hughes

Vetem gjate vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

### "JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN"

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.  
Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

### "NIGHT SCHOOL"

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.  
Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

### "SIBERIA",

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.  
Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

### "VENOM" 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.  
Regjia: Ruben Fleischer  
Based on the Marvel Comics



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).

FOTO E DITES



Një djalë duke luajtur futboll në një plazh në ishullin Filipinas në Boracay. /AFP/

E rrallë

## Njeriu merimangë u ngjit në ndërtesën më të lartë të Londrës

Francezi Alain Robert është ngjitur pa litar në ndërtesën më të lartë të Londrës. 56-vjeçarit iu desh një orë të ngjitej në Kullën Heron, 230 metra të lartë, në distriktin financiar të kryeqytetit bri-



tanik. Më parë ai është ngjitur në më tepër se 150 kulla të tjera të botës: në Burj Khalifa të Dubait, që është kulla më e lartë e botës; në Kullën Eiffel të Parisit, në Operën e Sidneit.

 <p><b>DASHI</b> Nuk do t'ju shpëtojnë detajet sot. Megjithëse në përgjithësi nuk ju kushtoni vëmendje, sot do të jeni mjaft i vëmendshëm.</p>	 <p><b>DEMI</b> Mjaft harmoni në punë ndërmjet kolegësh. Pak problematik raporti në çift ku dikush kërkon shpjegime.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Keni mjaft mirëkuptim në familje ku secili bën atë që i takon duke ju lënë kohë të lirë në dispozicion.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Jeni disi ëndërrimtar gjatë pjesës së parë të ditës. Shumë shpejt një problem do t'ju kthejë me këmbë në tokë.</p>	 <p><b>LUANI</b> Sot po e kapni veten shumë herë duke menduar për të shkuarën. Doni të qëndroni vetëm me kujtimet tuaja.</p>	 <p><b>VIRGJËRISHA</b> Jeni shumë korrekt sot me detyrimet tuaja. Nëse do të kishit një reciprocitet dhe nga personat e tjerë dita do të ishte e përkryer</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Hëna në shenjë sot ju bën romantik më tepër se zakonisht. Shumë mirë paraqitet edhe ana juaj financiare.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Logjika dhe racionaliteti nuk ju mungojnë sot. Kjo do t'ju shërbejë edhe miqve tuaj që shpeshherë janë tepër impulsivë.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Sot do të keni një jetë sociale me mjaft angazhime. Autokontrolli shumë herë ju ka privuar nga kënaqësi të vogla.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Intuita juaj po ju paralajmëron për një ngërç të vogël në jetën në çift. Mundohuni të gjeni arsyen pse ka ndodhur.</p>	 <p><b>UJORI</b> Sot dëshira juaj shkon tek kreativiteti gjërat e bukura dhe udhëtimet. Do të keni nevojë për shoqëri të mirë.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Sot do të jenë emocionet tuaja ato që do t'ju drejtojnë në zgjedhjet që do të bëni.</p>

## Jason Derulo u këndon fansave nga ballkoni



Jason Derulo u ka kënduar fansave nga një ballkon, në vend të një arene, pasi koncerti i tij në Pragë u anulua për arsye sigurie. Shfaqja në Tipsport Arena u anulua vetëm disa orë para se të fillonte, ndaj 29-vjeçari improvizoi një koncert. Edhe pse ripercaktoi një datë

tjetër për koncertin, ai nuk dëshiron që fansat e tij të largoheshin të mërzitur. Ndaj u ngjit në një ballkon dhe filloi të këndonte. Ai ka shkruar në "Instagram": "Dashuria dhe miqësia që kemi ndarë mbrëmë do të mbetet përgjithmonë tatuazh në zemrën time".

## Jenna Dewan e Channing Tatum zyrtarisht po divorcohen



Shtatë muaj pas ndarjes së tyre, Jenna Dewan zyrtarisht është duke u ndarë me Channing Tatum. Dewan paraqiti dokumentacionin për divorc javën e kaluar në

Los Anxhelos. Në dosje, Dewan ka kërkuar kujdestarinë e përbashkët juridike dhe fizike të vajzës së tyre pesëvjeçare Everly si dhe ka kërkuar mbështetjen e fëmijëve.



## Rita Ora tjetërsohet për 'Halloween', performon si 'mashkull' në koncertin e fundit në Londër

Me rastin e afrimit të festës së 'Halloween' -it, shumë prej figurave publike kanë filluar ta ndryshojnë pamjen e tyre, duke tentuar të duken ndryshe dhe 'të frikshëm'. Një gjë të tillë e ka bërë edhe këngëtarja shqiptare me

famë botërore, Rita Ora, në koncertin e fundit. Së fundmi, ajo ka mbajtur një koncert gjigant në stadiumin e madh "Wembley" të Londrës, ku ka performuar para mijëra fansave hitet e saj më të mëdha.

## Kjo është gjendja e Niall Horanit pas operimit të sinuseve

Niall Horan është më mirë tani. "Dua t'ju tregoj se unë kam pasur një operacion për shkak të sinuseve të mi dhe shërimi po shkon shumë mirë", ka shkruar në "Twitter" ish-anëtari i grupit One Direction. "Ashtu siç kam thënë, unë do të jem larg jush për një kohë, por doja ta dinit arsyen", ka shkruar ai. Në muajin qershor, artisti ka njoftuar se pas turneut të tij botëror do të merrte pushim duke nisur nga shtatori.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

TOTTENHAM - MAN CITY

4+

ALEN - KAISERSLAUTERN

2

LAZIO - INTER MILAN

GG

# Kosova rrëmben katër medalje në Abu Dhabi

Xhudo vazhdon ta prezantojë denjësisht sportin e Kosovës në arenën ndërkombëtare. Akil Gjakova ia ka siguruar medaljen e tretë të argjendtë dhe të katërt në përgjithësi Kosovës në Grand Slamin e Xhudos Abu Dhabi 2018. Të shtunën medalje të argjendta fituan Majlinda Kelmendi dhe Distria Krasniqi, kurse të artën e rrembi Nora Gjakova

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 28 TETOR - Ekipi i xhudos së Kosovës ka shkëlqyer edhe në një tjetër garë ndërkombëtare, pasi ka arritur t'i rrëmbejë plot katër medalje në Grand Slamin e Xhudos Abu Dhabi 2018. Nora Gjakova e fitoi medaljen e artë, kurse vëllai i Norës, Akili dhe xhudistet Majlinda Kelmendi dhe Distria Krasniqi, kanë fituar medaljet e argjendta. Nora Gjakova në kategorinë -57 kilogramë ka treguar një permormacë të lartë dhe arriti që në finale për më pak se një minutë ta mposhtë rusen Anastasia Konkina. Gjakova është kampione e Evropës, kurse më këtë rast fitoi 100 pikë olimpikë. Rikthim të suksesshëm nga lëndimi ka pasur edhe Majlinda Kelmendi, e cila ishte në rrugë të duhur për ta rrëmbyer medaljen e artë, por një lëndim në hundë bëri që ajo ta dorëzojë finalen përballë italianes Odette Giufrida dhe në fund u stolisën me medaljen e argjendtë në kategorinë -52 kilogramë. Krenaria e sportit të Kosovës fiton 700 pikë olimpikë. Medaljen e argjendtë e fitoi edhe Distria Krasniqi. Kjo e fundit në finale u mposhtë nga garuesja e Mongolisë, Munkhbat Urantsetseg, në kategorinë -48 kilogramë. Krasniqi shënoi katër fitore, ndërsa në gjysmëfinale mposhti kampionen olimpikë, Paula Pareto. Të dielën garuesi i fundit, Akil Gjakova, u paraqit shkëlqyeshëm, por me pak fat ka mundur të stolisët me medaljen e artë. Kësaj radhe Akili e fitoi medaljen e argjendtë në kategorinë -73 kg, duke shtuar plus 700 pikë olimpikë. Xhudisti nga Peja realizoi katër fitore dhe një pa luftë, derisa në finale u mposht nga Lata Tatashduashvilli i Gjeorgjisë.



Trajneri Driton Kuka e ka lavdëruar paraqitjen e garuesit Akil Gjakova, duke thënë se ai bëri një luftë burrërore. "Finalisti i Abu Dhabi Grand Slam, porsa doli nga lufta e fortë dhe burrërore. E argjendtë me shkëlqim të artë medalja e Akilit, e katërt për Kosovën. Lufta finale ishte repriza e Grand Slamit në Paris. Atje fitoi Akili e tash garuesi gjeorgjian, përndryshe kampion olimpik. Ekipin e ëndrrave e kemi krijuar. Do të kemi 4-5 norma olimpikë në Tokio 2020", ka thënë Kuka, i cili ka lavdëruar edhe tri

xhudistet për performancë dhe fitimin e medaljeve ditën e shtunë. "Nora ishte e paparë. Majlinda u rikthye fuqishëm, por u lëndua në luftën çerekfinale dhe në finale gjakderdhja e tepërt e detyroi mjekun ta ndërpresë luftën, vendim të cilin e përkraha edhe unë. Lëndimi nuk është serioz, përveç gjakderdhjes që s'lejon të vazhdohet finalja. Distria ishte si në ditët më të mira", ka shtuar Kuka. Xhudo vazhdon të jetë sporti kryesor në Kosovë, pasi sukseset në secilin garë ndërkombëtare nuk po mungojnë.

SHKURT

## Khaka dhe Shaqiri shënojnë në Angli, Kololli dhe Lenjani në Zvicër

Granit Khaka ka shënuar një supergol në ndeshjen që Arsenali e ka zhvilluar të dielën ndaj Crystal Palaces (2-2). Vendësit shënuan dy gola nga penalltia nëpërmjet Luka Milivojeviqit, kurse për Arsenalin shënuan Granit Khakla nga gjuajtja e lirë dhe Pierre-Emerick Aubameyang. Skuadra e Liverpoolit ka shënuar fitore 4-1 ndaj Cardiff Cityt, në ndeshjen e Premierë Ligës. Në këtë ndeshje ka shënuar gol edhe shqiptari Xherdan Shaqiri, kurse dy gola i ka shënuar Sadio Mane dhe një tjetër Mohamed Salah. Gol në këtë fundjavë ka shënuar edhe reprezentuesi i Kosovës, Benjamin Kololli, në ndeshjen ndaj St. Gallenit, por në fund skuadra e tij FC Zuerich pësoi humbje 3-2. Emir Lenjani ka shënuar golin e parë për Sionin në ndeshjen ndaj Young Boysit në minutën e 17, mirëpo në fund skuadra e Lenjanit është mposhtur me rezultat 3-2. Shqiptari tjetër Pajtim Kasami nuk është inkadruar fare në lojë.

## Rikthehet Januzaj

Futbollisti shqiptar Adnan Januzaj është rikthyer nga lëndimi, kurse është paraqitur në tetë minutat e fundit në ndeshjen që Real Sociedadit e humbi nga Atletico Madridi (2-0), në kuadër të La Ligës. Januzaj ishte lënduar gjatë verës në Kupën e Botës ku ishte pjesë e Belgjikës, e cila zuri vendin e tretë.

## Federeri fiton trofeun e 99 në karrierë

Tenisti zviceran Roger Federer fitoi finalen e Bazelit dhe fitoi titullin e nëntë të karrierës në këtë turne. Federeri ishte më i mirë në sete 7:6, 6:4 se rumuni Mariuis Copil. Ai në këtë mënyrë mbajti pozitën e tretë në listën e renditjes ATP para Masterëve në Paris dhe Londër. Ky është titulli i tij i 99 në karrierë.

## U18-sht e Kosovës kampion në "IHF Trophy"

U18-shat e Kosovës në hendboll janë shpallur kampionë në "IHF Trophy" për Evropë. Hendbollistët e Kosovës në finale fituan ndaj Britanisë së Madhe me rezultat 36:31. Me titullin e kampionit, Kosova është kualifikuar për "IHF Trophy Interkontinental", që mbahet vitin tjetër. Është ky një sukses i madh për U18 që i fituan të gjitha katër ndeshjet e luajtura: ndaj Britanisë së Madhe, Moldavisë dhe Shqipërisë.

## "El Clasico" e Barcelonës

BARCELONË, 28 TETOR - Barcelona e ka fituar "El Clasico"-n ndaj Real Madridit me rezultat bindës 5-1. Pavarësisht prej mungesës se Lionel Messit, Barcelona është treguar skuadër superiore

ndaj rivaleve më të mëdhenj në histori, Realit të Madridit, që edhe një herë e ka të pamundur mbulimin e mungesës së Cristiano Ronaldos, i cili në verë u transferua në Juventus.

Barcelona e nisi më mirë ndeshjen dhe në minutën e 11 shënoi Philippe Coutinho. Kur kaluan tridhjetë minuta lojë, Luis Suarezit e dyfishoi epërsinë me golin nga penalltia. Në fillim të pjesës së dytë

Marcelo e ngushtoi epërsinë në 2-1, por kjo nuk ndikoi që Barcelona të ndalet. Luis Suarezit shënoi edhe dy gola të tjerë, kurse Arturo Vidalit e komplettoi fitoren e Barcelonës me rezultat 5-1.





## Shaqiri: Liverpooli mund ta fitojë Ligën e Kampionëve

LIVERPOOL, 28 TETOR - Mesfushori me origjinë shqiptare i Liverpoolit, Xherdan Shaqiri, beson se skuadra e drejtuar nga Jurgen Kloppi përbëhet nga lojtarët mjaftueshëm të mirë për ta fituar titullin e Ligës së

Kampionëve këtë sezon. "Unë e kam fituar titullin e Ligës së Kampionëve me Bayern Munchen dhe kjo ishte një ndjenjë e pabesueshme. Ëndërroj ta përsëris këtë sukses me Liverpoolin dhe pse jo? Janë

kujtime të mrekullueshme, kështu që pse mos ta bëj përsëri. Ne kemi kualitetin për të arritur shumë larg dhe vitin e kaluar ata arritën deri në finale. Ata nuk e fituan titullin e Ligës së Kampionëve, por ne do të tentojmë ta

bëjmë të njëjtën edhe këtë sezon. Së pari duhet të performojmë mirë dhe në fund do ta shohim. Kemi ende një rrugë të gjatë deri atëherë dhe duhet të vazhdojmë me paraqitje të mira", ka thënë Shaqiri.



## Feronikeli ruan kryesimin në elitë



PRISHTINË, 28 TETOR - KF Feronikeli e ruan kryesimin në elitën e futbollit të Kosovës edhe pas xhiros së 12-të, pasi shënoi fitore në Mitrovicë ndaj Trepçës '89. Golin e vetëm për skuadrën nga Drenasi e shënoi mbrojtësi Arbër Prekazi pas një ore lojë. Në ndeshjen tjetër të zhvilluar të shtunën, Prishtina e mposhti me lehtë sesa që është pritur skuadrën e Gjilanit me

rezultat 0-3. Golat për fitoren e skuadrës "bardhekaltër" i shënuan Ergyn Ahmeti, Meriton Korenica dhe Lorik Boshnjaku. Pas kësaj fitore, Prishtina mbetet vetëm dy pikë pas skuadrës lidere, Feronikelit. Në ndeshjen tjetër të zhvilluar në Skenderaj, fitues doli Llapi ndaj Drenicës (0-2). Pas trembëdhjetë minutave lojë Bujar Idrizi shënoi nga gjuajtja e lirë për

IPKO SUPERLIGA		
Trepça '89 - Feronikeli		0-1
Gjilani - Prishtina		0-3
Drenica - Llapi		0-2
Ferizaj - Flamurtari		2-3
Ballkani - Liria		1-0
KEK-u - Drita		1-2

TABELA		
1. Feronikeli	11	26 pikë
2. Prishtina	11	24
3. Llapi	12	23
4. Drita	12	19
5. Flamurtari	12	19
6. Drenica	12	18
7. Gjilani	12	17
8. Trepça '89	12	15
9. Ballkani	12	15
10. Ferizaj	11	10
11. Liria	12	9
12. KEK-u	11	1

rezultat 0-1, kurse rezultat final në fund të ndeshjes e vulosi Edon Zeqiri. E veçanta e kësaj xhiroje ishte se nga gjashtë ndeshje, pesë fitore u kanë takuar skuadrave mysafire, kurse si vendës fitoi vetëm Ballkani ndaj Lirisë së Prizrenit.

## Lakersat marrin tjetër leksion nga San Antonio

LOS ANGELES, 28 TETOR - Pas dy fitoresh radhazi ndalet sërish skuadra e Lakersit, që u mund 110-106 nga San Antonio, që triumfon dy herë brenda një jave ndaj ekipit kalifornian. Një ndeshje e mirë e DeRozanit, që realizoi 30 pikë e 12 rebaunde për Spursin, duke i bërë të pavlefshme 35 pikët e 11 rebaundet e LeBron Jamesit për Lakersin. Vijon të zhgënjë skuadra e Clevelandit, që sot pësoi humbjen e gjashtë radhazi (nuk ka asnjë fitore në kampionat). Cavaliersi u mund 119-107 nga Indiana, ku sërish mungon lojtari-lider, ndërsa për miqtë nuk dalluan Bogdanoviçi me 25 pikë e Oladipo me 24. Sezoni i Milwaukee ka nisur në mënyrën më të mirë të mundshme, me 6 fitore e asnjë humbje, duke qenë surpriza e deritanishme në NBA. Skuadra e Bucksit mposhti 113-91 Orlandon, ndeshje e dominuar nga skuadra vendëse, me Antetokounmpo që realizoi 21 pikë, ndërkohë që edhe stoli bëri difer-



encën (41 pikë). Fiton edhe Bostoni, që mundi 109-89 Detroitin, një përballje klasike mes dy ekipesh pretendente për titull. Për Celticsin u dallua Brown me 19 pikë, ndërkohë që 62 pikë erdhën nga lojtarët e stolit. Chicago mundi 97-85 Atlantën falë 27 pikëve e 11 rebaundeve të LaVine.

REZULTATET	
Detroit - Boston	89-109
New Orleans - Utah Jazz	111-132
Atlanta - Chicago	85-97
Cleveland - Indiana	107-119
Philadelphia - Charlotte	105-103
Memphis - Phoenix	117-96
Miami - Portland	120-111
Milwaukee - Orlando	113-91
San Antonio - Lakers	110-106

### SHKURT

#### Prishtina e njofton Rahovecin me humbje

KB Z Mobile Prishtina e ka njoftuar me humbje KB Rahoveci, pasi e ka mposhtur në ndeshjen derbi të zhvilluar në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në kryeqytet (107-86). Nikoqirët luajtën më mirë në çerekun e parë në të cilin shënuan 33 pikë, kundrejt 20 pikëve të mysafirëve. Edhe në dhjetëminutëshin e dytë skuadra vendëse bëri performancë më të mirë se kundërshtari (29:18) dhe shkoi në pushim me epërsi bindëse (62-38). Rahoveci u përpoq të rikthehet në fraksionin e tretë duke shënuar vetëm një pikë më pak se (26:25) kryeqytetasit që vazhdonin me epërsinë e lartë. Mysafirët e fituan çerekun e fundit të ndeshjes (19:23), porse mbetën shumë prapa liderit me pikë (107-86).

#### Vinales fiton në Australi

Maverick Vinales siguroi një fitore dominuese në Çmimin e Madh të Australisë në MotoGP, këtë të diel, teksa kampioni i sapokurorëzuar i botës, Marc Marquez, u detyrua të dilte në mënyrë dramatike nga gara, duke zgjatur edhe më tej tersin e tij në pistën "Phillip Island". Piloti spanjoll i Yamahas, i cili e nisi garën nga vendi i dytë dhe mori kryesimin pas tërheqjes së Marquezit, arriti kështu fitoren e tij të parë për këtë sezon, duke lënë pas krahëve Andrea Iannonen me Suzuki. Piloti i Ducatit, Andrea Dovizioso, e mbylli garën në vendin e tretë, duke shtuar mundësitë për të dalë nënkampion i sezonit, pasi rivali i tij më i afërt, Valentino Rossi, nuk shkoi më shumë sesa vendi i 6. Edhe pse feston për këtë sezon, pati sërish zhgënjim për Hondën dhe Marquezin, i cili siguroi titullin e 6 kampion bote në klasën mbretërore në Japoni, javën e kaluar. Marquezi regjistron një statistikë shqetësuese: ka dështuar ta përfundojë garën në Australi në tri raste, 2014, 2016 dhe 2018.

#### Berisha merr vlerësime pozitive

Etrit Berisha mori mundësinë e tij tek Atalanta dhe e shfrytëzoi në maksimum. Portieri i kombëtares shqiptare u rikthye titullar në ndeshjen që skuadra nga Bergamo fitoi 3-0 kundër Parmës. Vlerësimet për të pas ndeshjes ishin pozitive. Vetë trajneri Gasperini e kishte paralajmëruar në konferencë për shtyp se do t'i jepte mundësinë Berishës, pasi Golini luajti titullar në disa takime radhazi. Mbetet për t'u parë nëse Berisha do të vijojë të luajë në vazhdimësi.

#### Juve interesohet për rikthimin e Pogbas

Ish-mesfushori i Juventusit, Pavel Nedved, që tash është zëvendës-president i kësaj skuadre, ka konfirmuar interesimin e "Zonjës së Vjetër" për Paul Pogban. "Sa i përket Pogbas, mund të them se është një ndër lojtarët më të fortë në botë, por është një mesfushor nën kontratë me Manchester Unitedin. Për momentin është e kotë të flasim, ne po e monitorojmë, afati kalimtar i janarit është ende larg, por në futboll nuk ekziston fjala kurrë", ka thënë Nedvedi.

#### Emery e dëshiron Matan në Arsenal

Trajneri Unai Emery e dëshiron në Arsenal, Juan Matan e Manchester Unitedit. Lajmi është bërë me dije nga "The Daily Star", kurse Mata dhe Emery kanë punuar bashkë në skuadrën e Valencias, para se spanjollit t'i bashkohet Chelsea. Ndryshe Arsenali ka arritur dhjetë fitore në dhjetë ndeshjet e fundit në të gjitha kompeticionet.



<b>Autor:</b> GAZMEND MORINA	ZË I BURRIT NDËRMJET TENORIT DHE BASIT	AKTORI ZHITOPOTOKU (shq.)	KUMTIM I GJERË ME SHKRIM, QË MBAHET PARA NJË MBLLEDH- JEJE (sh.shq.)	↓	GËZIM I MADH KALIUM, IRIDIUM	EMËR MASHKULLI MYSLIMAN
SHTËPIZA E NDËRTUAR ME DËRRASA						
ANËTARËSIM NË NJË ORGANIZATË						
GJYQTARI SPORTIV						
PËREMËR PRONOR				ISH BOKSIERI YNË LIKA	BASHKËT. AKTORI RAFUNA (shq.)	
DESPOT						BASHKËT.
ZANORE		KRYEMURG OHAJO, FLORIDA				AKTORI I FAMSHËM ... AFLECK
FLETORE E VOGËL PËR MBAJTJEN E SHËNIMEVE DITORE						QYTET NË ZVICËR BAKËRPUN- UES

<b>SUDOKU</b>									
	1			2		6			
		6						9	
8	2		1	9				4	
		1			4				3
	9		5	3				2	
3			7			5			
	7			3	1			5	6
4	8						1		
				4					3

<b>EPOKA E RE</b>	LEGJENDA E FUTBOLLIT NË FOTO	NJËRA NËDËR TRI GJINITË KRYESORE TË KRIJIMTARISË LETRARE	SHTET FEDERAL NË SHBA	KOHË E NDARË PËR PUNË	I SHKALLËS MË TË ULËT	ELIZABETH TAYLOR	TENISTI I NJOHUR ROGER LARTËSI E NJË LËNGU NË NJË ENË					PRODUKT ZJARRI DJALLËZOR (hebr.)				
DUKURI	○						BANOR I KRYEQYTETI SHQIPTAR FEUDAL QË I NËNSHTROHEJ MBRETTIT						BASHKËT. SHTET FEDERAL NË SHBA			
LËNDË MJEKUESE QË HAP APETITIN	○							MINDER I ULËT (vjet.) EMËR YNI MASHKULLI				KËNGËTARJA VALENTINA LUMË I MADH NË AFRIKË				
KANAPE E GJERË DHE E GJATË SI SHTRAT	○					FUTBOLLISTI HOLANDEZ RAFAEL ... DER VART			FLETË LETRE PËR DUHAN	TË ARDHURAT VJETORE TË PAPËS					IPSVICH	
FLUTURUESI I PARË SIPAS MITOLOGJISË	○					PIKTORI ... VALLA KOMPOZITORI ... KOCI					KOLOS					
LEARNING AIM DATABASE	○			KLUB FUTBOLLI SPANJOLL VEÇORI THELBËSORE E NJË SENDI							PARAGRAF SKUADËR SPORTIVE (shq.)				FAQE E NJË TRUPI (shq.)	
BASHKËT.	○	SULM RRËSHQANOR I MADH					SHTET NË AFRIKË (pashq.) ZHANËR I MUZIKËS						REGJISORI ... QOSJA QË KA TË BËJË ME ATAVIZMIN			
OLIVER KAHN	○		AKTORI PRAPASHTICA NUKLEARE				JO SHUMË TRAVEL INSURANCE DIRECT				MARC ANTHONY	KËNGËTAR I FAMSHËM AMERIKAN (shqip.) MURGU I VETMUAR				
LLOJ PESHKU	○				LËNG SYRI PORTIERI ... HOWARD (EVERTON)			VLERË, DOBI (vjet.) KAFSHË SHTËPIAKE PËRTYPËSE E IMËT					TEDI ALVES BANOR I NJË SHTETI SKANDINAV			
RRETH PREJ DRURI A PREJ METALI QË VË NË LËVIZJE NJË MJET (sh.shq.)	○					KËNGËTARI AMERIKAN ... ROCK DY BASHKË- TINGËLLORE			PARAKALIMI USHTARAK I SHKRETUAR; I BRAKTISUR						QYTET NË KOSOVË	
I TURPËROJ	○						KAFSHË PËRTYPËSE SHTËPIAKE SHKRIMTARI ... SHEHU				AKTORJA LONGORIA				BASHKËT. PRAROJ	
<b>EPOKA E RE</b>	OLIVIER MARTINEZ MENDIM			KUNDREJT NËN LITËR, AMPER, METËR			LITUANIA (shk.) ISMET RAMUSHI					MJET SHPËRTHYES (sh.shq.) LICENSING EXECUTIVES SOCIETY				
DASHURI E THJESHTE DHE E PASTËR (libr.)					SUEDIA, ESTONIA	VALUAR DY BASHKË- TINGËLLORE					LLOJ PIJE ALKOOLIKE (shq.) PAMELA ANDERSON					
RESOR									PRAPË ZANORE				"ZOMERSA" BASHKËT.			
SECILA NGA PJESËT QË FORMOJNË NJË TË TËRË							VENDËS, RRËNJËS (sh.shq.)						SELEN			

ZGJIDHJA E FJALËKRYQIT: BARAKA, ABERIM, REFERI, IME, R, TIRAN, O, ABAT, NOTES, BAZEL, FEDERER, HIO, FENOMEN, TIRANAS, R, APERITIV, NIM, RAMA, DIVAN, VAN, ANATI, IKARI, ESAT, TITANI, LAD, MALAGA, ALINE, V, ATAK, LIBERI, ISA, OK, LIRI, PAK, AKON, KRAP, LOT, KIMET, TA, RROTAT, KID, PARADA, I KORIT, DEVE, EVA, SH, OM, MBI, LIT, MINAT, IDIL, ZIER, LIKERI, LIKERI, DIKASTER, APET, ZOM, ELEMENT, ANASIT, SE, ZGJIDHJA E SUDOKUT: Kolona 1:914 325 687; KII:536 478 291; KIII:827 196 345; KIV:751 284 963; KV:698 513 724; KVI:342 769 518; KVII:279 831 456; KVIII:483 652 179; KIX:165 947 832.







**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

► Brikena Kavaja nga Prishtina, shpallë të pavlefshme ID-kartelën e Fakultetit AAB-Prishtinë me nr. RE-3948/13.

► Bashkëpronarja Vesna Grujic shet pjesën e vetë ideale në parcelën kadastrale P-70202018-00001K-0 Zona Kadastrale Gojbule Komuna e Zveçanit. Ftohen bashkëpronaret që nëse janë të interesuar për blerje të kësaj prone të lajmërohen te i autorizuari i saj Savic Dimitrije nga Zveçani.

► Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

► Urgjentisht kërkoj banesë me qira ne Prishtine, për një çift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

**Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistralja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë e përshtatshme dhe për banim kolektiv. Tel. 044-413-197, wiber: 045-198-095.**

► Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

► Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

**Lëshoj shtëpinë me qira, e cila gjendet në lagjen e "Universiteti" përball rrugës B dhe përball marketit Viva Fresh Store. Shtëpia është 100 metra katror dhe e mobiluar. Është e përshtatshme për zyre dhe banim. Numri kontaktues 049-574-169.**

**OFERTË PËR SHITJE TË SHTËPISË**

Shitet shtëpia dykatëshe, me sipërfaqe prej 218 m2, dhe trualli me sipërfaqe prej 410 m2.

Shtëpia gjendet në Prishtinë, në lagjen "Aktash I", rr. "Ferhat Draga" nr. 1.

Procedura e transaksionit nga shitësi te blerësi bëhet pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes dhe pagesës së çmimit të kontraktuar, pastaj paluejtshmëria e përshkruar më lart kalon te blerësi.

Çmimi sipas marrëveshjes.

**Informata më të hollësishme mund të merren në numrin e telefonit 001-347-331-8305 në Nju Jork, kurse në Prishtinë në celularin 044-166-580.**

# AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla  
"RITMO - L"  
Prishtinë**

**Eksperiencia jonë  
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:**

**Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

**Tel / kontakt:**

**044 248 173**

**044 200 604**

**044 375 333**



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria  
Vlada-Government  
Ministria e Zhvillimit Ekonomik  
Ministarstvo Ekonomskog Razvoja-Ministry of Economic Development

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme /Departman za Finansije i  
Opšte Usluge /Department of Finance and General Services

Ministria e Zhvillimit Ekonomik duke u bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës L. Nr. 03/L-149 dhe Rregulloren nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës bënë:

### SHPALLJEN E REKRUTIMIT

Departamenti i Minerave  
Numri i Konkursit: APF0004311  
Vendi i punës: Zyrtar i Lartë për Resurse minerale Energjetike, Jo-metallore dhe Bilanc -  
EZHE/360  
Koeficienti : 8.00  
Kohëzgjatja e Emërimit: Pa afat të caktuar  
Mbikëqyrësi: Udhëheqësi i Divizionit për Resurse Minerale dhe Bilanc

#### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Grumbullon, përpunon dhe përgatit dokumentacionin teknik të shfrytëzimit të resurseve Minerale Energjetike dhe Jo-metallore ;
- Përgatit bilancin e resurseve minerale Energjetike dhe Jo-metallore të shfrytëzueshme;
- Merr pjesë në hartimin e Strategjisë dhe Programin e Zbatimit të Strategjisë Minerare;
- Merr pjesë në përgatitjen dhe hartimin e legjislacionit primar dhe sekondar për sektorin mincrar;
- Merr pjesë në përgatitjen e propozim listës për Rentat Mincrar;
- Harton raporte të rregullta për të dhënat e bilancit të resurseve minerale Energjetike dhe Jo-metallore si dhe aktiviteteve minerare;
- Merr pjesë në shqyrtimin dhe propozim miratimin e Planit të Mënximit të resurseve minerale;
- Kryen edhe detyra tjera që dalin nga legjislacioni për sektorin mincrar;

#### Kualifikimi i nevojshëm :

- Diplomë Universiteti nga drejtimi i gjeologjisë apo xehtarisë;
- Të ketë së paku 3 vite përvojë pune;
- Aftësi në punë ekipore dhe ndërmarrje të iniciativave;
- Njohuri e legjislacionit përkatës vendor dhe ndërkombëtar për lëmin e xehtarisë, përpunimit, shfrytëzimit dhe plasmanit të produkteve minerale;
- Aftësi të avancuara me kompjuter MS Windows, MS Office (Word, Exel, Power Point, Project, Outlook);
- Aftësi të punon në mënyrë efektive në mjedisin multi-etnik dhe multi-kulturor;
- Aftësi të punon në nivelin më të lartë të konfidencialitetit dhe transparencës;

#### Procedura e konkurrimit

Procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatët të jashtëm si dhe nëpunës civil ekzistues të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Kërkesa për punësim dhe përshkrimi i punës mund të merret në recepcionin e ndërtesës së Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (Sheshi Nëna Terezë, Toskanë, Prishtinë) Formularin zyrtar për aplikim, mund ta gjeni edhe në Web faqen <http://mzhe.rks-gov.net>.

Aplikacionit duhet të bashkëngjiten dokumentet përcjellëse si vijon: Formulari i plotësuar i aplikimit, dëshminë për kualifikimet arsimore dhe profesionale (diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT-i), dëshminë e përvojës së punës, dy referenca. Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe ai i pakompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pavlefshëm. Kërkesat dorëzohen në Zyrën e Arkivës, kati I-rë, ndërtesa e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik ose me postë.

#### Informata e përgjithshme për të gjithë kandidatët

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Komunitetet jo shumicë kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistimit.

Kohëzgjatja e emërimit sipas LSHC, duke përfshirë periudhën e punës provuese një (1) vjeçare.

#### Afati i konkurrimit është prej datës 29/10/2018 deri me date 12/11/2018, deri në orën 16:00.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të konkurrimit nuk do të pranohen. Për informata shtesë, ju lutemi telefononi në numrat: 038 200 21524



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria  
Vlada-Government  
Ministria e Zhvillimit Ekonomik  
Ministarstvo Ekonomskog Razvoja-Ministry of Economic Development

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme /Departman za Finansije i  
Opšte Usluge /Department of Finance and General Services

Ministarstvo za ekonomski razvoj na osnovu Zakona o javnoj službi Republike Kosovo br.03/L-149 i Uredbe br. 02/2010 o postupku zapošljavanja u javnoj službi Republike Kosovo, objavljuje:

### OGLAS ZA ZAPOSŁJAVANJE

Departman rudarstva  
Broj Konkursa: APF0004311  
Radno mesto: Viši službenik za energetske mineralne energije, nemetalne resurse i bilans -  
EZHE/360  
Koeficientat : 8.00  
Trajanje imenovanja: Na neodređeno vrijeme  
Nadzornik: Rukovodilac divizije za mineralne resurse i bilans

#### Dužnosti i odgovornosti:

- Sakuplja, obrađuje i priprema tehničku dokumentaciju o korišćenju energetske mineralne energije i nemetalnih resursa;
- Priprema bilans energetske mineralnih i nemetalnih resursa koji se mogu iskoristiti;
- Učestvuje u izradi Strategije i Programa implementacije strategije rudarstva;
- Učestvuje u pripremi i izradi primarnog i sekundarnog zakonodavstva za rudarski sektor;
- Učestvuje u pripremi predloga liste mineralne rente;
- Izrađuje redovne izveštaje o stanju Bilansa mineralne energije i nemetalnih resursa, kao i o rudarskim aktivnostima;
- Učestvuje u razmatranju i predlogu usvajanja Plana upravljanja mineralnim resursima;
- Vršiti druge dužnosti koje proizilaze iz zakona o mineralnom sektoru;

#### Potrebna kvalifikacija :

- Univerzitetsku diplomu iz oblasti geologije ili rudarstva;
- Da ma najmanje 3 godine radnog iskustva;
- Timski rad i inicijativu;
- Poznavanje relevantnog lokalnog i međunarodnog zakonodavstva o rudarstvu, preradi, eksploataciji i plasiranju mineralnih proizvoda;
- Napredne računarske veštine MS Windows, MS Office (Word, Exel, Power Point, Project, Outlook);
- Sposobnost delotvornog delovanja u multietničkom i multikulturalnom okruženju;
- Sposobnost rada na najvišem nivou poverljivosti i transparentnosti;

#### Postupak konkurisanja

Postupak konkurisanja je otvoren za spoljne kandidate, kao i za postojeće javne službenike koji uspunjavaju kriterijume konkursa. Prijava za zapošljavanje i opis radnog mesta mogu se preuzeti na recepciji zgrade Ministarstva za ekonomski razvoj (Trg Majke Tereze, Toskana, Priština). Zvanični obrazac za prijavu, možete preuzeti na internet stranici: <http://mzhe.rks-gov.net>.

Uz zahtev potrebne je priložiti sledeću prateću dokumentaciju: Popunjeni obrazac, dokaz o obrazovnim i stručnim kvalifikacijama (diplome stečene u inostranstvu treba da budu nostrifikovane od strane MONT), dokaz radnog iskustva, dve reference.

Korišćenje pogrešnog obrasca i obrazac nepopunjen traženim podacima, smatraće se nevažećim. Prijave se dostavljaju Kancelariji za arhivu, I sprat, zgrada Ministarstva za ekonomski razvoj ili putem pošte.

#### Opšte informacije za sve kandidate

Ministarstvo za ekonomski razvoj, pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve državljane Kosova, i dobrodošle su prijave od svih osoba muškog i ženskog pola iz svih zajednica na Kosovu.

Manjinske zajednice imaju pravo na pravičnu i proporcionalnu zastupljenost u organima javne službe, kao što je utvrđeno u članu 11. stav 3. Zakona br. 03/L-149 o javnoj službi u Republici Kosovo.

Zbog velikog broja primljenih prijava, kontaktiraće se samo kandidati koji uđu u uži izbor.

Kandidati koji su izabrani u uži izbor će proći kroz pismeni ispit i intervju.

Trajanje imenovanja prema ZSL, uključujući i period probnog rada je godinu dana.

#### Rok za prijave je od datuma 29/10/2018 do datuma 12/11/2018, do 16:00

Konkurs će ostati otvoren 15 dana od dana objavljivanja u dnevnoj štampi.

Zahtevi podneti nakon isteka roka za konkurs, neće biti uzeti u obzir.

Za dodatne informacije, molimo pozovite sledeći broj: 038 200 21524





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

